



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT / OFFICE OF THE PRIME MINISTER / URED PREMIJERA

AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE
AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA
AGENCY FOR GENDER EQUALITY

PREZANTIMI I GRAVE NË MEDIAT E SHKRUARA 2014-2015

Mars, 2017





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT / OFFICE OF THE PRIME MINISTER / URED PREMIJERA

AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE
AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA
AGENCY FOR GENDER EQUALITY

PREZANTIMI I GRAVE NË MEDIAT E SHKRUARA 2014-2015

Mars, 2017





STRATEGY &
DEVELOPMENT
CONSULTING

Ky raport është përgatitur nga Strategy and Development Consulting me mbështetjen dhe financimin e Agjencisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA). Të gjitha të drejtat e këtij raporti i takojnë Agjencisë për Barazi Gjinore (ABGJ), Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

PËRMBAJTJA

| | |
|---|----|
| Shkurtesat | 7 |
| Përbledhje | 8 |
| 1. Hyrje | 10 |
| 2. Korniza ligjore dhe institucionale | 12 |
| 3. Hulumtimet dhe raportet e mëparshme | 14 |
| 4. Analiza sasiore e materialit të mbledhur | 17 |
| 4.1 Metodologja | 17 |
| 4.2 Gjetjet e analizës sasiore | 17 |
| 5. Analiza sasiore e materialit të mbledhur | 27 |
| 5.1 Analiza Kritike e Diskursit dhe Analiza Semiotike Multimodale | 27 |
| 5.2. Mostra e analizës cilësore | 29 |
| 5.3 Artikujt e analizuar | 31 |
| 6. Grupi i fokusit me gazetarë | 57 |
| 6.1 Metodologja | 57 |
| 6.2 Gjetjet kryesore nga grupi i fokusit | 57 |
| Përfundimet dhe rekomandimet | 61 |
| Referencat | 63 |

Shkurtesat

ABGJ – Agjencia për Barazi Gjinore

BE – Bashkimi Evropian

CEDAW – Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas

GSIM – Treguesit e Ndjeshëm Gjinorë për Media

NATO – Aleanca Veriatlantike

OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara

OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

PKBGj – Programi i Kosovës për Barazi Gjinore

UNESCO – Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara

Përbledhje

Ky hulumtimi është bazuar në vlerësimin e artikujve të shtatë gazetave ditore të mbledhura gjatë viteve 2014-2015 që shtjellojnë tema të cilat kanë të bëjnë me vajzat dhe gratë. Qëllimi i hulumtimit ka qenë vlerësimi i prezantimit sasior dhe cilësor të grave në to, si dhe roli që shkrimet e gazetave ditore luajnë në krijimin e një klime të favorshme për luftimin e stereotipeve gjinore dhe promovimin e barazisë gjinore.

Për më shumë, ky hulumtim ka për qëllim edhe përbushjen e objektivave strategjike të Ligjit për Barazi Gjinore, Programit të Kosovës për Barazi Gjinore (PKBGj) 2008-2013, si dhe Planit të Veprimit të Bashkimit Evropian 2016-2020, të cilat përcaktojnë qartë detyrimet dhe obligimet e institucioneve publike, dhe institucioneve mandati i të cilave përkon me media, në lidhje me promovimin e barazisë gjinore.

Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë se mediat e shkruara kanë shënuar progres në disa prej komponenteve kyçë të raportimit mbi çështjet gjinore, të cilat kontribuojnë në promovimin e përgjithshëm të barazisë gjinore në Kosovë. Në këtë drejtim, vlen të theksohet gatishmëria e gazetave ditore për t'iu dhënë hapësirë grave të suksesshme në fusha të ndryshme. Rasti i xhudisteve Majlinda Kelmendi e Nora Gjakova, dhe portretizimi i drejtë i sukseseve të tyre në arenën ndërkombëtare është një tregues i qartë i qasjes pozitive, jodiskriminuese dhe promovuese të gazetave ditore karshi sukseseve të vajzave dhe grave kosovare. Në anën tjetër, është inkurajues raportimi i drejtë dhe jodiskriminues i gazetarëve në lidhje me projektet e suksesshme të grave në fushën e kulturës. Përderisa në sport vërehet një dëshirë e theksuar e gazetave për të promovuar sukseset e vajzave dhe grave në Kosovë e sidomos në arenën ndërkombëtare, në fushën e kulturës hasim në një raportim tejet objektiv nga aspekti i perspektivës gjinore, ku vetë sasia e storieve rezulton në një prezantim promovues të grave të suksesshme në këtë fushë.

Në anën tjetër, gjatë hulumtimit është vërejtur një tendencë pozitive në përzgjedhjen e fotografive dhe imazheve në artikujt ku protagonisti janë gratë. Vlen të theksohet se përderisa paraqitura vizuale e sportisteve dhe artisteve është gjithmonë korrekte dhe adekuate, një tendencë e tillë pozitive vërehet edhe në fotografitë të cilat përcjellin artikujt ku protagonisti kryesore janë gratë politikane. Gratë të cilat zënë hapësirën më të madhe të përfaqësimit në fushën e politikës dhe vendimarrjes në përgjithësi janë: Presidentja Atifete Jahjaga, Kryetarja e Komunës së Gjakovës, Mimoza Kusari-Lila, si dhe Edita Tahiri, e cila udhëhiqte procesin e negociatave të Kosovës me Serbinë. Edhe në pjesën tekstuale të këtyre artikujve në fushën e politikës, por edhe në atë të ekonomisë e barazisë gjinore, ka përmirësime të dukshme. Në këtë drejtim, mund të veçohet gatishmëria e gazetarëve për të marrë parasysh dhe prezantuar në mënyrë objektive pikëpamjet e protagonisteve të këtyre artikujve, si dhe hartimin e shkrimeve bazuar në citate të drejtpërdrejta.

Përkundër këtyre elementeve pozitive, ekzistojnë fusha në të cilat vërehet nevoja për përmirësimë të mëtejme. Mungesa e njohurive për konceptet bazike të barazisë gjinore dhe raportimit përmes perspektivës gjinore është ende e theksuar në mesin e gazetarëve. Si rezultati i kësaj, pjesa më e madhe e artikujve që kanë të bëjnë me dukuri negative të cilat cenojnë sigurinë dhe integritetin e grave, siç janë ato për dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave, kanë një karakter kryesisht informativ, ku informacioni i dhënë është i nivelit deskriptiv, dhe nuk bëhen përpjekje, së pari për ta kuptuar dhe pastaj për ta shtjelluar kompleksitetin e temave të tillë përmes një qasjeje analitike. Për më shumë, artikujt e kësaj fushe karakterizohen nga një mungesë e theksuar e ndjeshmërisë gjinore, gjë që shpeshherë rezulton në prezantimin e vajzave dhe grave ekskluzivisht përmes prizmit të viktimës, duke mos marrë mundin për të analizuar shkaqet, pasojat dhe implikimet më të gjëra të këtyre rasteve. Në këtë drejtim, një vëmendje e shtuar duhet t'i kushtohet përmirësimi të qasjes së gazetarëve në raport me shkrimet që ngërthejnë në vete nocione komplekse, siç janë morali, seksualiteti dhe normat e etabluara shoqërore e kulturore.

Gjithashtu, gjatë hulumtimit është vërejtur nevoja për përmirësimin e qasjes së gazetave ditore ndaj promovimit të barazisë gjinore në përgjithësi. Është e rëndësishme që një gjë e tillë të bëhet jo vetëm përmes ofrimit të hapësirës së mjftueshme, por edhe përmes shkrimeve cilësore të cilat si qëllim përfundimtar kanë vetëdijesimin dhe edukimin e qytetarëve për rolin dhe kontributin e grave në sfera të ndryshme të shoqërisë.

Përderisa është inkurajues fakti se shumë prej gazetave ditore kanë redaktore, e disa edhe kryeredaktore si dhe gra në pozita udhëheqëse menaxheriale, një gjë e tillë jedomosdoshmërisht përkthehet në qasje më të ndjeshme gjinore në raport me gazetat ku burrat mbajnë pozitat kyçë.¹ Së këndejmi, është e rëndësishme të theksohet se përkatësia gjinore e individëve në pozitat kyçë redaktoriale nuk është indikator i cilësisë më të lartë të raportimeve nga perspektiva gjinore. Në anën tjetër, gjatë punës në këtë hulumtim, është vërejtur se, për ndryshim nga redaktorët dhe kryeredaktorët, përkatësia gjinore e gazetarëve ndikon drejtpërdrejt në mënyrën e raportimit të temave ku protagonistë kryesore janë gratë. Megjithatë, edhe në këtë rast, mungesa e njohurive për mbulimin e temave me implikime gjinore luan rolin kryesor në përcaktimin e cilësisë së shkrimeve.

Në përfundim, vlen të theksohet se në Kosovë ka gra kompetente dhe profesionalisht të përgatitura të cilat minden dhe duhet të përfshihen më shumë në rolin e eksperteve në artikuj të ndryshëm. Mirëpo, gjatë analizës së materialit dhe diskutimeve me vetë gazetarët, është vërejtur se atyre rrallëherë u jepet mundësia për bashkëpunim. Duke qenë se mediat kanë, deri në një masë, monopol mbi promovimin e personave të caktuar në shoqëri, dhe misioni i tyre shkon përtej raportimit ditor të lajmeve, është e rëndësishme që perspektiva gjinore të jetë pjesë e pandashme e politikave redaktoriale, me qëllim të prezantimit dhe afirmimit të gruas dhe roleve të saja të shumëfishta në shoqërinë kosovare.

¹ Përkundër përpjekjeve për të intervistuar dy redaktore dhe një kryeredaktore, një gjë e tillë nuk ka qenë e mundur për shkak të mosgatishmërisë për bashkëpunim.

1. Hyrje

Sipas një ankete të bërë nga INDEX Kosova në vitin 2009, televizioni mbetet burimi kryesor i informacionit në Kosovë. Rreth 86% e respondentëve të kësaj ankete kanë thënë se informohen nga televizioni, 5% kanë thënë se informohen nga radio, kurse 7% nga gazetat. Edhe pse mungesa e të dhënavë më të freskëta e bën më të vështirë që ky hulumtim të konkludojë nivelin e saktë të ndikimit të secilit medium, megjithatë mund të thuhet se pozita e gazetave në këtë renditje ka shënuar rënje të vazhdueshme.

Me rritjen e përdorimit të internetit në mbarë botën, njerëzit gjithnjë e më shumë informohen nga platforma të ndryshme të mediave digjitale në krahasim me mediat tradicionale. Vetëm në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, rreth 62% e të rriturve marrin informacione nga rrjetet sociale.² Kosova nuk është përjashtim në këtë trend botëror. Në vitin 2013, penetrimi i internetit në Kosovë ka qenë 84.8% për ekonomi shtëpiake, apo 76.6% për kokë banori.³ Edhe pse nuk ka të dhëna të sakta, numri i kosovarëve të cilët informohen ekskluzivisht nga mediat *online* është duke u rritur shumë shpejt.

Shumica e gazetave ditore që janë pjesë e këtij hulumtimit u janë përshtatur këtij trendi duke i publikuar shkrimet e tyre edhe në internet, dhe duke i shpërndarë ato nëpër rrjetet sociale. Një trend i tillë, i përcjellur me nivelin gjithnjë e më të ulët të shitjes së gazetave, dëshmon se mediat e shkruara më nuk paraqesin burimin primar prej të cilit informohen kosovarët. Së këndejmi, është e rëndësishme të theksohet se qëllimi i këtij hulumtimit është vlerësimi i prezantimit të grave në mediat e shkruara, dhe jo niveli i ndikimit që këto shkrime kanë tek lexuesit. Megjithatë, çfarëdo hulumtimi i ardhshëm i cili do të merret me vlerësimin e ndikimit, qoftë pozitiv apo negativ, të gazetave tek lexuesit, duhet të marrë parasysh evoluimin e peisazhit mediistik, si në botë ashtu edhe në Kosovë, si dhe ndryshimet dhe riformatimet e vazhdueshme në relacionet mes prodhuesve dhe konsumuesve të informacionit.

Sipas një raporti të OSBE-së të vitit 2010 mbi tirazhin dhe politizimin e mediave të shkruara në Kosovë, të gjitha gazetat ditore të cilat kanë qenë operacionale atë vit, së bashku kanë pasur një tirazh ditor prej 25 mijë deri 35 mijë kopje. Sipas këtij raporti, një tirazh kaq i ulët i gazetave ditore ndodhë për shkak se shumica e gazetave fokusohen kryesisht në raportime të thjeshta protokollare, dhe shpesh sipërfaqësore, e jo në gazetari hulumtuese dhe shkrime analitike. Përveç kësaj, raporti thekson se kryeredaktorët e gazetave përmendin sistemin e dobët të distribuimit si njërin nga shkaqet e një niveli të tillë të tirazhit të gazetave. Modeli ekzistues i distribuimit nuk bazohet në konceptin e ofertës dhe kërkesës, por përdorë kuota

2 Jeffrey Gottfried dhe Elisa Shearer, *News Use Across Social Media Platforms 2016*, Pew Research Center. 26 maj, 2016. [http://www.journalism.org/2016/05/26/news-use-across-social-media-platforms-2016/0/](http://www.journalism.org/2016/05/26/news-use-across-social-media-platforms-2016/)

3 Fazliu A. (2013). *Depërtimi dhe përdorimi i internetit në Kosovë*. Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit të Kosovës (STIKK): http://stikk.org/fileadmin/user_upload/Depertimi_dhe_perdorimi_i_internetit_ne_Kosove_01.pdf

statike për shpërndarjen e gazetave në pikat shitëse në gjithë Kosovën. Si rezultat, numri i kopjeve të një gazete që është në dispozicion të lexuesve mbetet gjithnjë i njëjtë, pavarësisht kërkesës për një gazetë të caktuar.⁴

Pavarësisht të gjithë faktorëve të përmendur më lartë, gazetat ende mbeten një faktor i rëndësishëm për prodhimin e informacionit. Përkundër tirazhit të ulët dhe faktit që kosovarët gjithnjë e më shumë zgjedhin platformat digitale për tu informuar, gazetarët janë ata që prodhojnë lajmin, e plasojnë atë dhe, së këndejmi, kontribuojnë në krijimin dhe formësimin e diskursit publik në Kosovë. Është e rëndësishme të theksohet se roli i gazetarëve në këtë drejtim ka të njëjtën peshë, pavarësisht llojit të mediumit përmes të cilit ata i bëjnë publike shkrimet dhe opinionet e tyre. Një tjetër faktor i cili shpjegon rëndësinë e rolit të gazetarëve është fakti se shumica prej tyre kanë filluar karrierën në gazetat ditore. Gazetat ditore janë prodhuese të informacionit, por njëherit shërbejnë edhe si platforma që nxjerrin gazetarë të rinj në treg, e të cilët më pas angazhohen edhe në mediat tjera, përfshirë ato elektronike dhe audiovizuele.

Qëllimi i këtij hulumtimi është që pikësëpari të vlerësojë se në çfarë mënyrë prezantohen gratë në mediat e shkruara, dhe në çfarë mase ushqehen apo luftohen stereotipet ekzistuese në lidhje me rolin e gruas në shoqërinë kosovare. Por, në një rrafsh më të gjerë, të dhënat nga hulumtimi i mëposhtëm mund të konsiderohen të dobishme edhe për faktin se jepin një pasqyrë më të qartë të qasjes së mediave të shkruara ndaj çështjeve të ndjeshme politike, shoqërore e kulturore, si dhe një vështrim kritik mbi objektivitetin, etikën dhe mendësinë e gazetarëve, si bartës kryesorë të informacionit dhe akterë kyç në krijimin e diskursit publik.

⁴ OSBE (2010). *Tirazhi dhe politizimi i mediave të shkruara në Kosovë*. <http://www.osce.org/sq/kosovo/67791?download=true>

2. Korniza ligjore dhe institucionale

Të drejtat elementare të njeriut, përfshirë edhe barazinë gjinore si pjesë integrale e tyre, janë të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kushtetuta⁵ garanton dhe afirmon parimet e barazisë gjinore të pranuara ndërkombetarisht, si dhe ndalon çfarëdo forme të diskriminimit, përfshirë edhe diskriminimin në baza gjinore.⁶

Kushtetuta parasheh që, edhe pse Kosova nuk është palë nënshkruuese e marrëveshjeve kryesore ndërkombe, të gjitha instrumentet ndërkombe të tē drejtave të njeriut të jenë drejtpërsëdrejti të zbatueshme. Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) gjithashtu është pjesë integrale e Kushtetutës, përkatësisht Nenit 22 të saj, dhe në rast konflikti, ka prioritet ndaj dispozitave e ligeve dhe akteve tjera të institacioneve publike.⁷

CEDAW është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1979. Konventa është ratifikuar nga 190 prej 195 shteteve anëtare të OKB-së. Qëllimi i CEDAW është të eliminohen të gjitha format e diskriminimit ndaj grave, dhe të arrihen liri të plota njerëzore dhe të drejta për gratë në kushte të barabarta me burrat. Konventa rikujton se diskriminimi kundër grave shkelë parimet e barazisë së tē drejtave dhe respektit për dinjitetin njerëzor, është pengesë për pjesëmarrjen e grave në jetën politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore të vendeve të tyre në mënyrë të barabartë me burrat, pengon rritjen e prosperitetit të shoqërisë, dhe vështirëson zhvillimin e plotë të potencialit të grave në shërbim të vendit dhe njerëzimit.

Promovimi dhe zbatimi i të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe trajtimi i barabartë i të gjithë qytetarëve të Kosovës gjithashtu rregullohet me pakon e legjislacionit për të drejtat e njeriut. Korniza ligjore e Kosovës lidhur me barazinë ndërmjet grave dhe burrave gjithashtu është përmirësuar me miratimin e ligjit të ri për barazinë gjinore.⁸ Ligji për Barazinë Gjinore (nr. 05/L-020) garanton, mbron dhe promovon barazinë gjinore si vlerë demokratike, dhe kërkon pjesëmarrjen dhe kontributin e të dy gjinive në sferën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, publike dhe në sferat tjera. Diskriminimi i bazuar në gjini ndalohet me Nenin 1 të Ligjit për Barazinë Gjinore. Për më tepër, obligohet trajtimi i barabartë pa diskriminim direkt apo indirekt bazuar në gjini, si dhe promovimi i barazisë gjinore.

5 Kushtetuta e Republikës së Kosovës (2008). <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

6 Agjencia për Barazi Gjinore (2012). Prezantimi i grave në mediat e shkruara 2010-2011.

<http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/ABCJ-Hulumtimi%20Grat%C3%AB%20n%C3%AB%20Mediat%20e%20Shkruara%20%202011-2012.pdf>

7 Kushtetuta e Republikës së Kosovës (2008). <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

8 Ligji për Barazinë Gjinore (2015). <https://mapl.rks-gov.net/getattachment/165dc3a6-5295-4d24-8437-a50f8ed4e237/LIGJI-NR--05-L-020-PER-BARAZI-GJINORE.aspx>

Ligji për Barazi Gjinore definon stereotipet gjinore si “pikëpamjet apo paragjykimet e përgjithësuar lidhur me tiparet apo karakteristikat që i takojnë apo do të duhej t’iu takonin, apo rolet që kryhen apo do të duhej të kryheshin nga meshkujt dhe femrat”.

Arritja e barazisë gjinore është me rëndësi qendrore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, funksionimin e demokracisë dhe respektimin e sundimit të ligjit, rritjen ekonomike dhe konkurrueshmërinë.⁹ Mirëpo, përkundër avancimit dhe demokratizimit të shoqërisë kosovare në vitet e fundit, gratë vazhdojnë të ballafaqohen me polarizimin tradicional të roleve gjinore, të përforcuara më tej nga stereotipet dominuese gjinore.¹⁰

Plani i ri i veprimit i BE-së për barazi gjinore (2016-2020), “Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave: transformimi i jetës së vajzave dhe grave përmes marrëdhënieve të jashtme të BE-së 2016-2020”, paraqet një qasje ambicioze ndaj barazisë gjinore, si dhe ndaj promovimit, mbrojtjes dhe realizimit të të drejtave të njeriut të grave dhe vajzave. Plani i ri i veprimit për barazi gjinore synon të koncentrojë përpjekjet e të gjithë akterëve të BE-së në tri lëmi tematike: integritetin fizik dhe psikologjik, të drejtat ekonomike dhe sociale, si dhe pjesëmarrjen e barabartë të vajzave dhe grave.¹¹

Me qëllim të integrimit të barazisë gjinore në politikat dhe programet publike të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) ka përgatitur Programin e Kosovës për Barazi Gjinore (PKBGj) i cili është miratuar nga Këshilli Drejtues i PKBGj-së më 19 mars të vitit 2008. Ky dokument përfshinë tetë objektiva strategjike: 1) Përhapjen e vlerave dhe praktikave që promovojnë barazinë gjinore, mbrojtjen e të drejtave, dhe fuqizimin e gruas; 2) Rritjen e qasjes së grave dhe vajzave në arsim cilësor; 3) Qasjen dhe cilësinë e shërbimeve shëndetësore për gra dhe vajza; 4) Fuqizimin ekonomik të grave; 5) Përmirësimin e situatës sociale të grave në rrezik; 6) Përmirësimin e punësimit për gratë dhe vajzat; 7) Përmirësimin e imazhit të grave në media, kulturë dhe sport; dhe 8) Pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e barabartë të të dy gjinive.

Objktivi i shtatë, “Përmirësimi i imazhit të grave në media, kulturë dhe sport”, shpjegon rëndësinë e përmirësimit të imazhit të grave në kulture, sport dhe media. Në kuadër të këtij objktivi, PBKGj tërheq vëmendjen për rolin e rëndësishëm që kanë mediat në ndryshimin dhe përmirësimin e opinionit shoqëror në lidhje me imazhin e grave dhe rolin e tyre në shoqëri. Programi po ashtu thekson se gazetarët dhe mediat kanë për obligim të mos riprodhojnë përvojat shoqërore seksiste dhe përjashtuese, të mos lejojnë praktika diskriminuese që përcjellin raportet hierarkike mbi bazën e dominimit mashkullor, të mos pranojnë norma që mbështesin inferioritetin femëror dhe që legjitimojnë dominimin mashkullor, si dhe të marrin pjesë në krijimin e një vizioni të ri për ndarjen e roleve gjinore.¹²

⁹ Council of Europe (2014). *Gender Equality Strategy 2014-2017*.

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=0900001680590174>

¹⁰ Agjencia për Barazi Gjinore (2012). Prezantimi i grave në mediat e shkruara 2010-2011.

<http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/ABGJ-Hulumtimi%20Grat%C3%AB%20n%C3%AB%20Mediat%20e%20Shkruara%20%202011-20012.pdf>

¹¹ O’Connell H. *The European Union’s new Gender Action Plan 2016-2020: Gender equality and women’s empowerment in external relations*. <https://www.odi.org/sites/odi.org.uk/files/odi-assets/publications-opinion-files/9926.pdf>

¹² Agjencia për Barazi Gjinore (2008), *Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2008-2013*. [http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/ABGJ%20Programi%20i%20Kosoves%20per%20Barazi%20Gjinore%20\(2\).pdf](http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/ABGJ%20Programi%20i%20Kosoves%20per%20Barazi%20Gjinore%20(2).pdf)

3. Hulumtimet dhe raportet e mëparshme

Ekziston një pikë e qartë përputhjeje ndërmjet fuqizimit të grave dhe zhvillimit të mediave. Mediat, pavarësisht teknologjisë së aplikuar, mbèsin një prej burimeve kryesore të informimit, ideve dhe mendimeve për shumicën e njerëzve në mbarë botën. Edhe pse ekzistojnë pabarazitë dhe stereotipet gjinore në strukturat shoqërore dhe në mendësinë e njerëzve, mediat kanë potencialin t'i përhapin dhe t'i përjetësojnë ato, apo së paku, ta zbusin ndikimin e tyre.¹³

Nëse mediat synojnë që të pasqyrojnë me saktësi shoqëritë tona dhe të ofrojnë një mbulueshmëri e cila është e plotë dhe e larmishme, është me rëndësi të madhe që lajmet në veçanti, ta pasqyrojnë botën në një mënyrë e cila është më e thellë sesa një botë me burrat në qendër dhe me këndvështrime stereotipike.¹⁴

Treguesit e Ndjeshëm Gjinorë për Media (GSIM) të UNESCO-s synojnë ta shtjellojnë këtë përputhje të fuqizimit të grave dhe zhvillimit të mediave. Fokusi kryesor i tyre është barazia dhe dimensionet gjinore të larmisë shoqërore në media.¹⁵ Treguesit gjinorë për media vënë barazinë gjinore mu në ballë të prioriteteve globale të UNESCO-s.

Raporti i mëhershëm i Agjencisë për Barazi Gjinore “Prezantimi i grave në mediat e shkruara 2010-2011”¹⁶ tregon se brenda artikujve ku janë prezantuar gratë, mbi 22% janë në fushën e politikës, pasuar nga temat në fushën e kulturës (13%) dhe temat sociale (8.2%), kurse në fushën e sportit, prezantimi i grave është bërë më së shumti përmes promovimit të sukseseve të sportisteve (55.8%). Në anën tjetër, raporti vë në pah faktin se në kuadër të “kronikës së zezë”, gratë më së shumti janë paraqitur në gazeta si viktima të dhunës në familje, apo në mbi 42% të rasteve. Në tërë materialin e analizuar, burrat citohen në rrith 70% të rasteve, ndërsa burrat dhe gratë citohen bashkërisht në të njëjtin artikull në 19% të rasteve.

Monitorimi i mediave globale në vitin 2010 tregon se 76% të asaj që njerëzit kanë dëgjuar apo lexuar në lajmet botërore ka të bëjë me burrat. Në këtë mënyrë, lajmet në media pasqyrojnë botën kryesisht si botë e burrave. Fatkeqësisht, Raporti i Monitorimit të Mediave Globale i vitit 2015¹⁷ thekson se gratë ende përbëjnë vetëm 24% të personave për të cilët dëgjohet, lexohet apo të cilët shihen në gazeta, në lajmet në televizioni dhe radio, përqindje kjo e njëjtë me atë të vitit 2010.

13 UNESCO (2012). *Gender-Sensitive Indicators for Media: Framework of indicators to gauge gender sensitivity in media operations and content.* <http://unesdoc.unesco.org/images/0021/002178/217831e.pdf>

14 Burimi i njëjtë

15 Burimi i njëjtë

16 Agjencia për Barazi Gjinore (2012). Prezantimi i grave në mediat e shkruara 2010-2011

<http://abgj.rks.gov.net/Portals/0/ABCJ-Hulumtimi%20Grat%C3%AB%20n%C3%AB%20Mediat%20e%20Shkruara%20%202011-2012.pdf>

17, The Global Media Monitoring Project (2015). *Gender inequality in the news 1995-2015.*

http://cdn.agilitycms.com/who-makes-the-news/Imported/reports_2015/highlights/highlights_en.pdf

Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim¹⁸ u themelua në Konferencën e Katërt Botërore të Grave, të mbajtur në shtator të vitit 1995, vitin e përvjetorit të pesëdhjetë të themelimit të Kombeve të Bashkuara. Deklarata e Pekinit shprehë vendosmërinë për të avancuar qëllimet e barazisë, zhvillimit dhe paqes për gratë kudo në botë, në dobi të të gjithë njerëzimit.

Ndër të tjera, Deklarata thotë se me përparimet në teknologji gjatë dekadës së fundit, mediat ushtrojnë ndikim në politikat publike, qëndrimet dhe sjelljet private, në veçanti tek fëmijët dhe të rinjtë. Në deklaratë theksohet se ekziston potencial gjithandej që mediat të jasin një kontribut më të madh në avancimin e grave.¹⁹

Deklarata më tutje bën thirrje për ndryshimin e paraqitjes së vazhdueshme të imazhit negativ dhe degradues për gratë në komunikimet mediatike - ato elektronike, të shtypura, dhe audiovizuele. Nisur nga fakti që mediat e shtypura dhe elektronike në shumicën e vendeve nuk paraqesin një imazh të baraspeshuar të jetës së larmishme të grave dhe kontributet e tyre në një botë dinamike, ato pothuajse automatikisht i kufizojnë gratë në rolet e tyre tradicionale. Deklarata thotë se "trendet mbarë botërore drejt konsumerezmit kanë krijuar një klimë ku reklamat dhe mesazhet komerciale shpesh portretizojnë gratë kryesisht si konsumatorë dhe vënë në shënjestër vajzat dhe gratë e të gjitha moshave në mënyrë jo të duhur".

Duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm që kanë mediat në formimin e mendësisë, një prej pikësynimeve të deklaratës është edhe promovimi i portretizimit të baraspeshuar dhe jostereotipik të grave në media. Veprimet që duhet të ndërmerren në këtë aspekt janë: inkurajimi i trajnimeve gjinore për profesionistët e mediave, përfshirë edhe pronarët dhe menaxherët e tyre, me qëllim të krijimit dhe përdorimit të imazhit jostereotipik, të baraspeshuar dhe të larmishëm për gratë në media.²⁰

Mirëpo, 20 vjet pas Platformës për Veprim të Pekinit, rishikimi i bërë në vitin 2015 nga Lobi i Grave Evropiane²¹ lidhur me aktivitetet e BE-së në këtë drejtim, tregon se gjendja nuk është përmirësuar dukshëm. Duke qenë se mediat formësojnë dhe do të vazhdojnë të ndikojnë fuqishëm në këndvështrimin tonë mbi botën, mediat në mbarë botën kanë dhënë dhe vazhdojnë të jasin një kontribut të rëndësishëm në avancimin e statusit të grave. Mirëpo, gratë në Bashkimin Evropian (BE) vazhdojnë të vuajnë nga një mungesë e theksuar e dukshmërisë në media. Për më tepër, prania e mëtejme e stereotipeve dhe diskriminimit gjinor pengon realizimin e barazisë ndërmjet grave dhe burrave. Së këndejmi, është me rëndësi të ceket se në BE, vetëm 24% e storieve në lajme kanë të bëjnë me gratë.²²

Barazia gjinore është në thelb të vlerave evropiane dhe është e përfshirë në kuadrin ligjor dhe politik të BE-së. BE-ja dhe shtetet e saj anëtare janë mu në ballë të mbrojtjes, përbushjes

18 Beijing Declaration and Platform for Action (1995).

<http://www.un.org/womenwatch/daw/beijing/pdf/BDPfA%20E.pdf>

19 Beijing Declaration and Platform for Action (1995). *Women and the media*, fq. 100.

<http://www.un.org/womenwatch/daw/beijing/pdf/BDPfA%20E.pdf>

20 Beijing Declaration and Platform for Action (1995). *Women and the media*, fq. 102.

<http://www.un.org/womenwatch/daw/beijing/pdf/BDPfA%20E.pdf>

21 European Women's Lobby. From Words to Action – Beijing+20 Report.

<http://www.womenlobby.org/From-Words-to-Action-Beijing-20-Report>

22 Burimi i njejtë

dhe gëzimit të të drejtave të njeriut nga gratë dhe vajzat. BE-ja gjithashtu i promovon fuqishëm këto të drejta në të gjitha raportet e saj të jashtme.²³

Për më tepër, pikësynimi i parë i Strategjisë për Barazi Gjinore të Këshillit të Evropës (2014-2017)²⁴ është “luftimi i stereotipeve dhe seksizmit gjinor”. Strategjia përcakton masat praktike për promovimin e një imazhi pozitiv dhe jostereotipik të grave dhe burrave në media, eliminimin e imazhit të grave si inferiore dhe të nënshtruara dhe stereotipeve për burrerinë e burrave, dhe pjesëmarrjen edhe më të baraspeshuar të grave dhe burrave në pozitat vendimmarrëse në media, me theks të veçantë në ato menaxheriale, programatike dhe organe rregullatore.

23 Council of the European Union (2015). *Council Conclusions on the Gender Action Plan 2016-2020*

<http://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2015/10/26-fac-conclusions-gender-development/>

24 Council of Europe (2014). *Gender Equality Strategy 2014-2017*.

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=0900001680590174>

4. Analiza sasiore e materialit të mbledhur

4.1 Metodologjia

Duke u bazuar në specifikat e këtij hulumtimi, kemi vendosur që të aplikojmë tri qasje metodologjike: analizën sasiore, analizën cilësore, dhe analizën e dokumenteve ekzistuese. Ky vendim është marrë për shkak se së bashku, këto tri metoda mundësojnë hulumtimin e plotë të të dhënave dhe pasqyrimin sa më real dhe konkret të prezantimit të grave në gazetat ditore në Kosovë.

Gjatë periudhës 2014-2015, ABGJ-ja ka përzgjedhur dhe mbledhur në baza ditore 1765 artikuj prej shtatë (7) gazetave ditore²⁵ të cilat janë analizuar nga ekipi i S&D Consulting. Me qëllim të pasqyrimit sa më të saktë të të dhënave, si pjesë e analizës sasiore, është krijuar baza e të dhënave me kodime te kategorive, të cilat janë ndarë në tema të ndryshme si: politikë, ekonomi, shëndetësi, kulturë, sport etj. Përpunimi i këtyre të dhënave është bërë me programin e specializuar statistikor SPSS 19, i cili ka mundësuar analizën deskriptive dhe krahasimore.

4.2 Gjetjet e analizës sasiore

Materiali i përzgjedhur nga ABGJ-ja i cili ka shërbyer si bazë e këtij hulumtimi përmban artikuj nga fusha të ndryshme, përfshirë politikën, ekonominë, kulturën, sportin, shëndetësinë, barazinë gjinore, dhuniën ndaj grave, etj. Për më shumë, materiali i analizuar përfshinë artikuj të llojeve të ndryshme, si lajme ditore, shkrime analitike, shkrime deskriptive, opinione, kolumnë, storie nga bota, etj., të publikuar si në ballinë, ashtu dhe në brendi të gazetave.


Gjatë hulumtimit, janë marrë parasysh Treguesit e Ndjeshëm Gjinorë për Media (GSIM) të UNESCO-s, përkatësisht pesë objektivat strategjike të prezantimit gjinor në përbajtjen e mediave. Edhe pse është bërë çdo përpjekje për të analizuar materialin e prezantuar më poshtë në bazë të këtyre treguesve, disa nga ta ka qenë e pamundur të merren parasysh, duke qenë se materiali i mbledhur gjatë fazës së monitorimit është fokusuar tërësisht në artikuj që kanë pasur të bëjnë ekskluzivisht me gratë. Artikujt me përbajtje rrëth burrave nuk kane qenë kriter i përzgjedhjes së artikujve dhe nuk janë përfshirë në materialin përfundimtar. Si pasojë, të dhënat e mëposhtme nuk paraqesin analizë krahasimtare të prezantimit të grave kundrejt burrave, por analizojnë prezantimin e grave në kuadër të përbajtjes së përgjithshme të gazetave specifike.

²⁵ Bota Sot, Epoka e Re, Koha Ditore, Kosova Sot, Lajmi, Tribuna, Zëri.

Si pasojë, objektivi i parë dhe i dytë strategjik i GSIM-ve që kanë të bëjnë me prezantimin e balancuar dhe portretizimin e drejtë të burrave dhe grave në media nuk janë marrë parasysh. Megjithatë, gjatë punës në analizën sasiore por edhe në analizën cilësore të artikujve specifik, ekipi hulumtues ka marrë parasysh tre objektivat tjera strategjike, të cilët përfshijnë:

- mbulimin e çështjeve të barazisë gjinore në lloje të ndryshme të përbajtjes (raportime, komente, intervista etj.), në fusha të ndryshme (politikë, ekonomi, shëndetësi etj.), të publikuara në pjesë të ndryshme të gazetës (faqet e ndara për lajme ditore, shkrime analitike, shkrime deskriptive, opinione, kolumnë, storie nga bota, etj.);
- dëshmi mbi "vetëdijen gjinore" të paraqitur në lloje të ndryshme të përbajtjes (raportime, komente, intervista etj.), në fusha të ndryshme (politikë, ekonomi, shëndetësi etj.), të publikuara në pjesë të ndryshme të gazetës (faqet e ndara për lajme ditore, shkrime analitike, shkrime deskriptive, opinione, kolumnë, storie nga bota, etj.);
- elementë të cilët tregojnë se mediat e shkruara e kuptojnë në mënyrë të saktë dhe holistike dhunën në baza gjinore në të gjitha format e saj si shkelje e të drejtave të njeriut, e njohur ndërkombetarisht në bazë të Deklaratës së Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave të vitit 1993.


Krahasimi i gazetave ditore sipas hapësirës së ndarë për gratë



Në grafikonin e mësipërm është bërë krahasimi i gazetave ditore dhe hapësirës që ato u jepin grave, bazuar në materialin e mbledhur. Kjo matje tregon se Koha Ditore me 28.9% është gazeta me më së shumti shkrime që kanë të bëjnë me gratë, pasuar nga Kosova Sot me 25.8%, Bota Sot me 17.9%, Zëri me 12.9%, Epoka e Re me 6.9%, Tribuna me 4.7%, dhe Lajmi me 2.9%. Gazetat me tirazhin më të lartë, Koha Ditore dhe Kosova Sot²⁶ u jepin hapësirë më të madhe artikujve që kanë të bëjnë me gratë, në krahasim me gazetat tjera me tirazh më të ulët.

²⁶ IREX Media Sustainability Index 2016. *The Development of Sustainable Independent Media in Europe and Eurasia*, fq. 70. <https://www.irex.org/sites/default/files/pdf/media-sustainability-index-europe-eurasia-2016-full.pdf.pdf>


Hapësira e ndarë sipas temave



Gratë në politikë është tema për të cilën ndahet më së shumti hapësirë në gazetat ditore në Kosovë, përkatësisht 28%. Pas saj, me radhë vjen hapësira e ndarë për tema që kanë të bëjnë me dhunën ndaj grave (17.4%), sportin (12.7%), kulturën (10.9%), jetën sociale (7.5%), gjyqësorin (4.6%), barazinë gjinore (4.1%), gratë e suksesshme (3%), shëndetësinë (2.7%), dhunën në familje (2.6%), ekonominë (2.1%), ekstremizmin fetar (1.8%), dhunën ndaj fëmijëve (1.3%), institucionet (0.9%) dhe korruptionin (0.4%).


Nga të dhënat e mësipërme, shihet qartë se politika është tema kryesore në të cilën gratë gjijnë hapësirën më të madhe në gazetat ditore në Kosovë. Megjithatë, duhet theksuar se një gjë e tillë nuk nënkupton as diskriminim pozitiv ndaj grave, e as rritje në numrin e grave të cilat janë përfshirë në politikë në vitet 2014-2015 krashtuar me periudhat e mëparshme. Këto të dhëna tregojnë se fusha e politikës është ajo që mbulohet më së shumti në gazetat ditore, dhe si pasojë, aktivitetet e grave në politikë pothuajse automatikisht gjëzojnë hapësirë më të madhe në krashtim me temat tjera.

Krahasimi i hapësirës së ndarë sipas temave në vite (2014-2015)



Në këtë grafikon është krahasuar hapësira që u jepet temave të përshkruara më sipër në vitet 2014 dhe 2015. Në të dy vitet, hapësira më e madhe në të gjitha gazetat e hulumtuara është ndarë për këto tema: politikë (29.6% në vitin 2014; 25.7% në vitin 2015), dhuna ndaj grave (15.6% në vitin 2014; 20.2% në vitin 2015), dhe sport (13% në vitin 2014; 12.3% në vitin 2015). Nga të dhënat del se në shumicën e temave dallimet mes këtyre viteve janë të vogla. Nëse hapësira që u jepet temave të ndryshme është indikator i incidencës së ngjarjeve që kanë të bëjnë me ato tema, atëherë mund të thuhet se çështjet pothuajse të njëjta kanë karakterizuar vitet 2014 dhe 2015. Megjithatë, në vitin 2015 artikujve për dhunën ndaj grave u është dhënë hapësirë më e madhe. Kjo jodomosdoshmërisht nënkuption edhe cilësinë më të madh në mesin e mediave të shkruara për të trajtuar këtë dukuri negative. Fotografitë korrekte të cilat përcjellin artikujt paraqesin një element tjetër pozitiv në mbulimin e kësaj teme.


Krahasimi i hapësirës së ndarë sipas temave në dy gazeta gjatë periudhës 2014-2015



Në këtë grafikon paraqitet hapësira e ndarë për këto tema në dy gazetat ditore, *Koha Ditore* dhe *Kosova Sot*, për vitet 2014-2015. Këto gazeta janë zgjedhur për tu krahasuar pasiqë gjatë këtyre dy viteve ato kanë ndarë hapësirën më të madhe për gratë në krahasim me gazetat tjera. Sipas këtyre të dhënave, temave që kanë të bëjnë me aktivitetin e grave në politikë në *Koha Ditore* u jepet hapësira më e madhe (24.7%). Në anën tjetër, *Kosova Sot* hapësirën më të madhe e ndanë për artikuj që kanë të bëjnë me dhunën ndaj grave (24.9%). Në *Kosova Sot*, hapësira e ndarë për gratë në politikë është më e vogël (19%), kurse *Koha Ditore* ndanë vetëm 13.9% të hapësirës së saj për artikuj që kanë të bëjnë me dhunën ndaj grave. *Koha Ditore* i jep dukshëm hapësirë më të madhe sportit (16.1%) se sa *Kosova Sot* (8.5%).


Vlen të theksohet se ky hulumtim nuk ka pasur për qëllim të vlerësojë cilësinë e secilit artikull veç e veç nga secila temë. Së këndejmi, edhe pse të dhënrat në grafikonin e mësipërm japin një pasqyrë të quartë të sasisë së artikujve për secilën temë, ato nuk paraqesin nivelin profesional të tyre. Ky dallim është posaçërisht i rëndësishëm në rastin e temë së dhunës ndaj grave dhe hapësirës që i jepet kësaj teme në *Kosova Sot*, ku është vërejtur tendenca për të favorizuar sasinë e artikujve para cilësisë së tyre. Tek këta artikuj vërehet një mungesë e theksuar e perspektivës gjinore dhe analizës objektive, dhe në të shumtën e rasteve informacionet e ofruara janë vetëm të nivelit deskriptiv. Analiza e një artikulli të tillë gjendet në faqen 48.

Hapësira e politikës e ndarë në tema



Përbrenda hapësirës së ndarë për politikë, pjesën më të madhe e zë tema për gratë në vendimmarrje me 65.8%, e pasuar me gratë në politikë me 21.8%, kurse për të dyja, gratë në politikë dhe në vendimmarrje në botë, gazetat ditore kanë ndarë 12.4% të hapësirës. Të gjithë artikujt e kësaj fushe bazohen në masë të madhe në citimet e drejtpërdrejta të protagonistave të temës, kurse paraqitja e tyre përmes fotografive është gjithmonë korrekte dhe në pajtim me natyrën e temës specifike të shtjelluar në artikull.


Pasqyrimi i dhunës ndaj grave sipas temave



Në kuadër të temave që shtellojnë dhunën ndaj grave, gazetat ditore hapësirën më të madhe e kanë ndarë për temat në vijim: dhuna në baza gjinore (39.6%), vrasjet (20%), trafikimi/prostitucioni (12.7%), dhuna seksuale gjatë luftës (9.4%), përkujdesja institucionale për të dhunuarat gjatë luftës (4.9%), diskriminimi gjinor (3.7%), tentim vrasjet (2.7%), ngacmimet seksuale në institacione (1.8%), rrëmbimet (1.7%), viktimat e luftës (0.9%), dhe vjedhjet (0.9%).

Duhet theksuar se përqindja për temën “vrasje” (20%) përfshinë artikujt nga Kosova dhe Shqipëria, të cilët janë mbledhur asisoji gjatë fazës së monitorimit. Artikujt nga Shqipëria përbëjnë pjesën më të madhe të kësaj hapësire.


Hapësira e ndarë për gratë në sport



Më shumë se gjysma e hapësirës për sport është e ndarë për xhudistet (69.6%). Pjesa tjetër e hapësirës përmban artikuj për gratë sportiste në botë (8.9%), gratë në sporte tjera (8.4%), hendballiste (4%), basketballiste (3.1%), notare (2.2%), boksiere (1.3%), dhe futballiste dhe volejballiste me nga 1.3%. Përveç tekstit, artikujt në këtë fushë kanë qenë gjithnjë të përcellur me foto adekuate dhe korrekte.


Sukseset e njëpasnjëshme të xhudisteve Majlinda Kelmendi dhe Nora Gjakova në arenën ndërkontebtare kanë bërë që tema e xudos ta zë hapësirën më të madhe. Edhe pse asnjëri nga artikujt e kësaj fushe nuk merr mundin që në mënyrë të drejtpërdrejt t'i inkurajojë vajzat e reja që të orientohen në sportet të cilave apriori u atribuohen tipare burrërore, shembujt e Majlinda Kelmendit dhe Nora Gjakovës, megjithatë, ndikojnë në mënyrë të tërthortë në inkurajimin e vajzave të reja që të merren me sport, dhe në veçanti, me sporte të cilat tradicionalisht konsiderohen burrërore.

Hapësira e ndarë për gratë në kulturë




Përbrenda hapësirës së ndarë për kulturë, pjesën më të madhe e zënë temat në vijim: gratë në art (29.7%), gratë në muzikë (28.8%), gratë në letërsi (17.6%), gratë në kulturë/botë (10.6%), kontributi i grave (6.9%), dhe gratë në film (6.4%). Në këtë fushë, fotografitë e përdorura janë cilësore dhe paraqesin në mënyrë të drejtë dhe adekuate protagonistet e ngjarjeve kulturore.

Hapësira e ndarë për gratë në shëndetësi




Sa i përket shëndetësisë, hapësira më e madhe në gazetat ditore i kushtohet shëndetit riprodhues të grave (26.3%), shëndetit nga pikëpamja institucionale dhe moskujdesit institucional ndaj grave me nga 19%, shëndetit të grave në botë (14.3%), shëndetit të grave (11.9%), shëndetit mendor (4.8%), dhe shëndetit të fëmijëve (4.7%). Edhe pse shumica e artikujve përbajnjë fotografi korrekte, ka raste kur fotografitë e përdorura paraqesin shkelje potenciale të së drejtës për privatësi të pacientëve. Një shembull i tillë mund të gjendet tek pjesa e artikujve të analizuar në faqen 38.

Hapësira e ndarë për tema për barazinë gjinore



Në hapësirën ku janë vendosur artikujt që kanë të bëjnë më barazinë gjinore, hapësirën më të madhe e zënë diskriminimi gjinor me 40.5%, fuqizimi i gruas me 12.3%, diskriminimi gjinor në botë me 10.8%, edukimi dhe e drejta pronësore me nga 9.4%, të drejtat e grave me 5.4%, identiteti gjinor me 4.3%, dhe gratë dhe feja me 2.7%.

Hapësira e ndarë për gratë në ekonomi



Në sektorin e ekonomisë, gazetat ditore hapësirë të veçantë u jepin grave ndërmarrëse (31.8%). Gazetat të cilat prijnë në ofrimin e hapësirës për gratë ndërmarrëse janë *Bota Sot* me 30%, *Koha Ditore*, *Kosova Sot* dhe *Epoka e Re* me nga 20% secila, dhe *Zëri* me 10%. Kategoritë tjera të cilave u jepet hapësirë në gazetat ditore në kuadër të sektorit të ekonomisë janë: gratë në vendimmarrje (15.8%), gratë dhe punësimi (13.1%), donacionet për gratë (10.5%), gratë në ekonomi (7.8%), dhe gratë e përfshira në afera korruptive (5.2%). Të gjithë artikujt janë të përcjellur me foto adekuate.

5. Analiza sasiore e materialit të mbledhur

5.1 Analiza Kritike e Diskursit dhe Analiza Semiotike Multimodale

Në kuadër të analizës cilësore të materialit të mbledhur, ky hulumtim do të bazohet në dy metoda kryesore: në Analizën Semiotike Multimodale të konceptuar dhe zhvilluar nga studiuesit Kress and Van Leeuwen, dhe Analizën Kritike të Diskursit të bazuar në qasjen e studiuesit Van Dijk. Vlen të theksohet se këto dy metodologji nuk e përjashtojnë njëra tjetrën, dhe në shumë pika kanë qasje të njëjtë. Për shembull, përderisa Analiza Kritike e Diskursit fokusohet më shumë në kontekstin social në të cilin prodhohet teksti, apo në rastin tonë, artikulli në gazetë, Analiza Semiotike Multimodale fokusohet në mënyrën se si një material i tillë i shërbeshet lexuesit. Kombinimi i dy metodave do të bëjë që analiza e artikujve të përzgjedhur më poshtë të jetë gjithëpërfshirëse dhe të shpjegojë të gjitha aspektet e prezantimit të grave në fusha të ndryshme shoqërore.

Analiza Kritike e Diskursit synon të tregojë se si raportimet në gazeta, publikimet qeveritare, raportet e shkencave shoqërore e shumë lloje tjera të shkrimeve edhe pse në shikim të parë duken të paanshme dhe thjesht informuese, munden, dhe në fakt shpeshherë përçojnë tek lexuesit qëndrime ideologjike.²⁷

Sipas Van Dijk, analiza kritike e diskursit është lloj i hulumtimit analistik të diskursit i cili, para së gjithash, synon të studiojë se si marrin formë dhe si riprodhohen abuzimi i fuqisë shoqërore, dominimi, dhe pabarazia, si dhe mënyrën se si u bëhet rezistencë të njëjtave përmes teksteve në kontekstin shoqëror dhe politik. Për më shumë, sipas Van Dijk, një analizë e tillë nuk është objektive në kuptimin strikt të fjalës, pasiqë qëllimi i saj përfundimtar është “pozicionimi i qartë disident”, kurse misioni i saj është që të kuptohet dhe ekspozohet pabarazia gjinore, dhe që të njëjtës t'i bëhet rezistencë.²⁸ Së këndejmi, analistët kritik të diskursit luajnë rolin e hulumtuesit të ideologjive të caktuara shoqërore të cilat promovojnë pabarazinë dhe abuzimin e fuqisë në dëm të minoriteteve shoqërore, kulturore e politike dhe të shtresave të diskriminuara në shoqëri.

Pjesa kryesore e metodologjisë së Van Dijk e cila do të përdoret në këtë hulumtim, është ajo që ka të bëjë me ndërtimin e diskursit. Si pasojë, analiza e artikujve do të përfshijë jo vetëm

²⁷ Anthonissen, C. (2001). On the effectivity of media censorship: An analysis of linguistic, paralinguistic and other communicative devices used to defy media restrictions, Disertacioni i doktoraturës, Universiteti i Vjenës, fq.300.

²⁸ Van Dijk, Teun A. (1998). *Discourse and power*, fq. 85. [Verzion i Google Books].

<https://books.google.com/books?id=OwwdbQAAQBAJ&printsec=frontcover&dq=inauthor:%22Teun+A+Van+Dijk%22&hl=en&sa=X&ved=0ahUKEwjjpNu80MDSAhXIBSwKHTYIDV8Q6AEIKjAD#v=snippet&q=dissident&f=false>

përshkrimin e teksteve, por do të mundohet të shpjegojë se si ndërtohet një diskurs i caktuar dhe se si ky ndërtim i diskursit ndërlidhet me vlerat e shoqërisë në të cilën ai operon.²⁹ Duhet theksuar se analiza kritike e diskursit është metodë e përshtatshme për të analizuar përbajtjen e gazetave ditore sepse ato prezantojnë informatat si në formë linguistike (teksti), po ashtu edhe në formë jolinguistike (fotografitë, ilustrimet, grafikonët etj.), duke influencuar kështu mendjen e lexuesit.³⁰ Ndërveprimi mes tekstit të shkruar, imazheve, dhe elementeve tjera grafike e vizuale është pjesë shumë e rëndësishme dhe e pandashme e çdo analize të tillë ku synohet të kuptohet ndërveprimi mes mediave ne njëren anë, dhe lexuesve në anën tjetër. Edhe pse matja e ndikimit që mediat e shkruara kanë tek lexuesit është përtej shtrirjes së këtij hulumtimi, ky hulumtim megjithatë merr parasysh faktin që mediat janë organizata shoqërore e politike të cilat, me ose pa vetëdije shtyjnë para një agjendë apo ideologji të caktuar.

Për të kuptuar dhe shpjeguar prezantimin e grave në mediat e shkruara në Kosovë, ky hulumtim do të marrë parasysh edhe metodën e "multimodalitetit" të zhvilluar nga studiuesit Kress dhe van Leeuwen. Sipas kësaj metode, përveç kategorive bazike të linguistikës si fjalët, fjalitë apo paragrafët, nevojiten terma më të përgjithësuar të cilat lejojnë analizë më të thukët të materialeve të cilat shpesh përbajnë në vete elemente tjera jashtë këtyre kategorive bazike. Module më këtë rast janë teksti, fotografitë, ilustrimet, ngjyrat, madhësia e shkronjave, dhe të gjitha elementet tjera që mund të hasen në artikull, e të cilat drejtpërdrejt apo tërthorazi kontribuojnë në prezantimin e materialit.

Gazetat janë të njobura për përdorimin e një gjuhe të caktuar gjatë prezantimit të çështjeve të ndryshme, e sidomos të atyre sociale. Përkundër normës profesionale të raportimit objektiv, të përqafuar qoftë edhe nominalisht, nga çdo gazetar si element kryesor i profesionit që ushtrojnë, përdorimi i kësaj gjuhe "gazetareske" është në kundërshtim me të shkruarit objektiv, i cili përfshin "raportimin e diçkaje të quajtur 'lajm' pa e komentuar, shtrembëruar, apo formuluar në një mënyrë të caktuar."³¹

Për më shumë, gazetarët të cilët kanë kontroll të plotë mbi shkrimet e tyre, kanë fuqinë ta përdorin këtë gjuhë me qëllim të promovimit apo degradimit të një ideologjie të caktuar, duke ndikuar kështu drejtpërdrejt në subjektivitetin e mendimit të lexuesit. Një tendencë e tillë vërehet më së miri në organizimin e secilit artikulli ne gazetë, ku pjesët kryesore janë: titulli, pjesa hyrëse/shpjegimi i pikave kryesore, dhe trupi i artikullit (teksti).

Duke qenë se titujt, sipas definicionit, duhet të jenë të shkurtër dhe të tërheqin vëmendjen e lexuesit, gazetarët tentojnë t'i shfrytëzojnë titujt për të shprehur pikëpamjet e tyre në lidhje me përbajtjen e stories. Edhe më brengosës është fakti se shumë prej lexuesve e mbajnë në mend vetëm titullin, duke e bërë kështu atë një pjesë shumë të rëndësishme, dhe njëkohësisht të ndjeshme të krijimit të diskursit publik. Në një studim mbi titujt e gazetave të vitiit 2011-2012 rrëth buxhetit të Pakistanit, studiuesit M. Mahmood, Javed, dhe R. Mahmood, kanë gjetur se titujt janë përfaqësues të ideologjisë së redaktorëve dhe animeve të tyre politike.

Pjesa hyrëse, anë anën tjetër, shërben për të shpjeguar edhe më tej përbajtjen që gjendet në tekst. Varësisht nga titulli, kjo pjesë pothuajse gjithmonë shërben për të forcuar më tej

29 Burimi i njëjtë

30 Kress G. R. dhe van Leeuwen T. (1996). *Reading images: The grammar of visual design*. [Verzion i Google Books]. https://books.google.com/books?id=vh07i06q-9AC&printsec=frontcover&source=gbs_ge_summary_r&cad=0#v=onepage&q&f=false

31 Schudson, M. (2001:150). *The objectivity norm in American journalism*.

mesazhin e përçuar në titull. Trupi i artikullit (teksti) përbëhet nga një sërë informata, detaje, shembuj statistika, të cilat shërbejnë si ilustrime konkrete dhe përforcues te justifikimit të ideologjisë së paraqitur në titull.

Duke marrë parasysh këto, secili artikull i analizuar më poshtë do të marrë parasysh këto tri elemente kryesore të shkrimit gazetaresk për të shpjeguar ndërlidhjen mes botëkuptimeve dhe animeve eventuale të artikullshkruesit në njëren anë, dhe në anën tjetër, kontekstit shoqëror, kulturor e politik i cili mundeson krijimin e një diskursi të caktuar publik në lidhje me rolin e grave në shoqëri. Sipas nevojës dhe varësisht nga lloji dhe formati i artikullit ne fjalë, përbrenda kësaj kornize analizuese, do të merren parasysh edhe elementet lingüistike kryesore të paraqitura më poshtë.

- Përemrat – si shënjes kryesore të kuptimit të teksteve
- Mbiemrat – të cilët përdoren gjatë përshkrimeve, qoftë pozitive apo negative, e të cilat japid indikacione rreth qëndrimit të gazetarit
- Metaforat – krahasimi implicit i dy personave apo gjëra që nuk janë të ndërlidhura mes vete, por që kanë karakteristika të përbashkëta
- Foljet – a janë aktive apo pasive?
- Narratori – a është shkruar artikulli në vetën e parë, dytë apo në vetën e tretë?
- Cilësia e “zërit” – a është “zëri” i artikullshkruesit agresiv, sarkastik, emocional etj.

Përveç këtyre elementeve, gjatë analizimit të artikujve do të merren parasysh edhe imazhet, fotografitë, dhe hapësira ku është vendosur shkrimi, me qëllim të dhënies së një pasqyre sa më të qartë të prioriteteve redaktoriale.

Ky hulumtim synon të analizojë mënyrën se si paraqiten dhe prezantohen gratë në mediat e shkruara në Kosovë, bazuar në gazetat e përzgjedhura, artikujt e monitoruar, dhe materialin përfundimtar të dorëzuar nga ABCJ-ja. Gjatë fazës së monitorimit, janë mbledhur artikuj nga shtatë (7) gazeta ditore në Kosovë, të shtypura dhe publikuara gjate viteve 2014 dhe 2015.³²

5.2. Mostra e analizës cilësore

Me qëllim të paraqitjes sa më të drejtë dhe të plotë të prezantimit të grave ne mediat e shkruara, është e një rëndësie të veçantë që analiza sasiore të përcillet me një analizë cilësore të artikujve të përzgjedhur gjate procesit të kodifikimit. Përderisa analiza sasiore ka për detyrë të tregojë se kur dhe ku haset volumi më i madh i artikujve që kanë të bëjnë me gratë, dhe rrjedhimisht të japë indikacione rreth asaj se sa u eksposozhen lexuesit këtyre artikujve, ajo megjithatë rrallëherë është e mjafshëm për të kuptuar dhe shpjeguar mënyrën se si gratë paraqiten në këta artikuj. Së këndejmi, për ndryshim nga analiza sasiore e cila jep një pasqyrë numerike të materialit në fjalë, analiza cilësore merret me nevojën për t’iu përgjigjur pyetjeve konceptuale të cilat konsiderohen të rëndësishme për tu përgjigjur, e jo me nevojën për të qenë sa më përfaqësuese.

Me qëllim të nxjerrjes së rezultateve sa më të pasura, artikujt e përzgjedhur dhe të analizuar janë përzgjedhur në bazë të kritereve në vijim:

- 1) Shkrime tipike/përfaqësuese
- 2) Shkrime negative/shqetësuese

³² Bota Sot, Epoka e Re, Koha Ditore, Kosova Sot, Lajmi, Tribuna, Zëri.

3) Shkrime të jashtëzakonshme apo mospërputhëse

Vlen të theksohet se analiza e artikujve në vijim është gjithëpërfshirëse, që do të thotë se janë marrë parasysh dhe analizuar të gjitha elementet relevante të cilat e bëjnë një artikull objektiv dhe profesional, apo të njëanshëm dhe tendencioz. Në këtë aspekt, gratë janë pjesë e të gjithë artikujve të analizuar më poshtë, por analiza e tyre shkon përtej vlerësimit të ngushtë të prezantimit vetëm të grave në to. Përkundrazi, analiza synon që të vë në pah të gjitha anët pozitive dhe negative të raportimeve dhe shkrimeve gazetareske të secilit artikull, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejt kontribuojnë në prezantimin pozitiv apo negativ të grave. Artikujt nuk janë ndarë në shembuj pozitiv dhe negativ, pasiqë një ndarje e tillë nuk do të ishte e natyrshme dhe do të pamundësonë analizimin e nuancave përbredha artikujve. Përkundrazi, secili artikull është analizuar si i tërë, duke përfshirë të gjitha elementet përbërëse relevante, si pozitive ashtu edhe negative.

5.3 Artikujt e analizuar

- “Pishmanët” e AAK-së
- **Gjakova, përkushtimi e dashuria e Mimozës**
- **Kurvat e Shqipërisë, në radhe për tu martuar me pleqtë beqar të Serbisë (Foto-Beograd)**
- **Si djemtë!**
- **Qendra ku trajtohen mbi 100 të sëmurë mentalë**
- **Teuta në LDK sjell vota dhe vlera**
- **Ermira Mehmeti kërkon më shumë vëmendje për Maqedoninë nga Tirana e Prishtina**
- **Kadriu thotë se hyri në PDK për t'ua kthyer buzëqeshjen qytetarëve**
- **Jahjaga: Gratë s'kanë trajtim të barabartë në shoqëri**
- **Burri e bën gruan PËR SPITAL**
- **Vetëm 16 për qind e femrave kanë prona**

04 Enjte, 28 maj 2015
Zeri | www.zeri.info

Ditari



Citat

"Deputetët ndonjëherë mund të gabojnë" e arsyeton ndryshimin e qëndrimit për Specialen deputetja e AAK-së, Teuta Haxhiu, e cila në mandatin e kaluar kishte votuar pro Speciales. Ajo thotë se e ka analizuar mërisë procesin e tanishëm të Gjykatës Speciale dhe ka ardhur në konkludim se kjo Gjykatë është në dëm të Kosovës dhe se ka për qëllim që ta njollosë luftrën e drejtë të UÇK-së.



"Pishmanët" e AAK-së

Lumturie Blakaj/Prishtine

Deputetët e Aleançës për Ardhmérinë e Kosovës (AAK) nesër pritet ta jepin votën kundër themelimit të Gjykatës Speciale, ndonëse një qëndrim krejt të kundërt kanë mbajtur në legjislaturën e kaluar.

Derisa disa deputeti të këtij subjekti politik ndryshimin e qasjes rreth Speciales e arsyetojnë, që thonë ata ma "gabime teknike", analistët politikë vlerësojnë se ky ndryshim i konceptit, sidomos i AAK-së rreth Gjykatës Speciale, nga mandati i kaluar ka të bëjë pikërisht me vazhdimin e qëndrimit të saj në opozitë.

Në legjislaturën e katërt të Kosovës, pro Gjykatës Speciale kishin votuar këtia deputetë të AAK-së: Donika Kadaj-Bujupi, Ardian Gjini, Burim Ramadani, Teuta Haxhiu, Kymete Bajraktari, Blerim Shala, Bali Muhamremaj dhe Xhevjet Neziraj, përdërsa kundër saj kishin votuar vetëm Daut Haradinaj, Ahmet Isufi dhe Time Kadriaj.

Haxhiu: Deputetët ndonjëherë gabojnë

Deputetët ndonjëherë mund të gabojnë" e arsyeton ndryshimin e qëndrimit për Specialen deputetja e AAK-së, Teuta Haxhiu, e cila në mandatin e kaluar kishte votuar pro Speciales. Ajo thotë se e ka analizuar mërisë procesin e tanishëm të Gjykatës Speciale dëm të Kosovës dhe se ka për qëllim që ta njollosë luftrën e drejtë të UÇK-së.

Edhe shefja e Grupit Parlamentar të AAK-së, Donika Kadaj-Bujupi, thotë se e ka ndryshuar pozicionin, duke u arsyetur se "shumë gjëra janë ndryshuar nga iniciativa që është marrë në fillim".

Por, transkripti i sancës plenare të Kuvendit të Kosovës i datës 23 prill 2014, kur ishte votuar për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Kosovës dhe BE-së mbi Misionin e EULEX-it shihet se qëndrimi i GP-së të AAK-së ka qenë që të votohet Gjykata.

Deputeti, Ardian Gjini, në atë kohë, sipas transkriptimit, kishte deklaruar se beson se është në të mirën e Kosovës që të votohet hapja e dyerve për krimjin e këtij gjyqit. "Nështu nuk e bëjmë atëherë do të krijohet një Tribunal ndërkombëtar për krimet në Kosovë", pati deklaruar Gjini.

Në bazë të një transkriptit që ka sruar gazeta "Zeri" shihet që edhe 4 deputetë të PDK-së kishin votuar kundër Gjykatës.

Shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së, Adem Grabovci, kishte thënë se partia e tij përkrah formimin e Gjykatës për disa arsyete, duke thënë se "beson fuqishëm në përbushjeje e obligimit përmbrnjtor dhe dëshmuar kudo para kujto që lufta janë ka qenë e drejtë dhe cilirimit". Konsistentë në qëndrim qëndron edhe partia e Isa Mustafës, LDK-ja, Ismet Beqiri sikur atëherë edhe task deklaron se deputetët e partisë së tij do të votojnë pro themelimit të Gjykatës Speciale, duke qenë të bindur se lufta e UÇK-së ka qenë e drejtë.

Ndërkaq, Jakup Krasniqi sa kishte genë në krye të Kuvendit të Kosovës e kishte kundërshtuar Specialen gjatë fjalimeve të tij, ndërsa në procesin e votimit kishte abstenuar.

Ndërkaq, deputeti Fatmir Limaj, i cili nuk ka marrë fare pjesë në procesin e votimit të Gjykatës, por në fjalën e tij kishte thënë se "një Gjykate, e cila do të ishte e verbër nga përkatësia nacionale e atyre që supozojnë që kanë kryer krim, por përdërsa në Parlamenti e Kosovës nuk shtrohet si çështje për të pasur një Gjykate e cila gjykon, i përcodën të gjitha krimet e supozuara, ne detyrohem të abstenojmë".

Muhamxhiri: AAK-ja ndryshoi qëndrim pas mbetjes në opozitë

Analistët politikë vlerësojnë se ky ndryshim i konceptit, sidomos i AAK-së, rreth Gjykatës Speciale nga mandati i kaluar në këtë mandat ka të bëjë pikërisht për shkak të mbetjes së saj jashtë pushtetit.

Artan Muhamxhiri thotë se deputetët e Kuvendit të Kosovës shpeshëherë kanë dëshmuar se nuk mund të janë konsistentë në qëndrimet e tyre. "Edhe GP-ja e AAK-së qëndrimin ndaj Gjykatës Speciale në këtë mandat e kanë ndryshuar për shkak të mbetjes në opozitë, duke synuar që të përfitojnë politikisht me këtë lloj kundërshtimi. Ndërkaq, në mandatin e kaluar ishte pajtuar për krimjin e Gjykatës.

Citat

"Edhe GP-ja e AAK-së qëndrimin ndaj Gjykatës Speciale në këtë mandat e kanë ndryshuar për shkak të mbetjes në opozitë, duke synuar që të përfitojnë politikisht me këtë lloj kundërshtimi. Ndërkaq, në mandatin e kaluar ishte pajtuar për krimjin e Gjykatës me shpresë se mund të vijë në pushtet, meqenëse pritej që të mbaheshin zgjedhjet nacionale", shënua Artan Muhamxhiri.

me shpresë se mund të vijë në pushtet, meqenëse pritej që të mbaheshin zgjedhjet nacionale", ka thënë ai. Si pas tij, deputetët kanë dëshmuar se nuk janë parimore në qëndrimet e tyre dhe gjithçka funksionon mbi interesat momentale.

Ndryshe, Kuvendi i Kosovës këtë të premte do t'i ketë para vetes amendent për ndryshime kushtetuese që i hapin rrugë Gjykatës Speciale dhe Draft-ligjin për Gjykatën. Koalicioni qeverisë PDK-LDK bashkë me minoritarët thonë se i kanë siguruar votat, derisa tri partitë opozitare janë deklaruar kundër Speciales.

Selia e Gjykatës Speciale për Krime Luftë pritet të jetë jashtë Kosovës, gjegjësisht në Hagë, kurse në përbëjen e saj do të janë vetëm prokurorë e gjykatës ndërkombëtarë dhe asnjë vendor.

Artikulli i mësipërm, i botuar më 26 maj të vitit 2015 në gazeten *Zëri*, flet për ndryshimet në qëndrime të disa prej deputetëve të njërs nga partitë politike opozitare në lidhje me votimin për themelin e Gjykatës Speciale. Fillimi, nuk është e qartë pse fjala pishman është e futur në thonjëza. Artikulli në të vërtetë flet për ndryshimin e qëndrimit mbi një çështje të caktuar nga ana e deputetëve, dhe fjala “pishmanët” në këtë rast i përshkruan ata si të pavendosur dhe labil në qëndrimet e tyre. Përderisa fjala “pishmanët” mund të jetë zgjedhje e gazetares, futja në thonjëza e kësaj fjale duket të jetë ose zgjedhje redaktoriale me qëllim të zbutjes së konotacionit jo edhe aq pozitiv të fjalës, ose lëshim teknik i redaktorëve përgjegjës si pasojë e mosnjohjes së funksionit të thonjëzave. Pavarësisht kësaj, artikulli flet për qëndrime të ndryshimeve politike, dhe si i tillë, përshkohet nga një ton mjaft gjykues dhe kritik, që më së miri vërehet në vetë titullin e artikullit.

Edhe pse artikulli flet për deputetë, si gra ashtu edhe burra, në artikull janë të vendosura dy fotografi, dhe që të dyja paraqesin dy gra, përkatësisht deputetet Donika Kadaj-Bujupi dhe Teuta Haxhiu. Një vendim i tillë redaktorial, i parë së bashku me titullin, jep një pasqyrë jo shumë të qartë të temës e cila shtjellohet. Përderisa termi “pishmanët” në titull mund të cilësohet si përshkrues i gjinisë mashkullore apo edhe asaj asnjanëse, fotografitë e dy deputeteve janë mjaft të qarta. Në rastin më të mirë, lexuesit e artikullit mund të ndjehen të hutuar nga një disonancë e theksuar mes këtyre dy elementeve kyçë të artikullit, kurse në rastin më të keq, ta kuptojnë atë si artikull i cili tregon se si gratë deputete të kësaj partie politike janë ato që ndërrojnë qëndrimet e tyre, dhe kushtmisht, dëmtojnë partinë e tyre apo procese të caktuara politike.

Dihet mirëfilli se shumica e lexuesve gjatë shfletimit të gazetës vendosin ta lexojnë një artikull të caktuar në bazë të titullit dhe fotografive. Por është po ashtu e vërtetë se shumica e lexuesve ndalen vetëm tek titulli dhe fotografitë, dhe nuk janë domosdoshmërisht të interesuar ta kuptojnë thelbin e artikullit duke e lexuar atë në tërsi. Për të parët, artikulli mund të jetë çorientues dhe jo i qartë, kurse ata që nuk ngurrojnë të nxjerrin përfundime vetëm në bazë të titullit dhe fotografive, artikulli i vendosë të gjitha gratë deputete në një kategori të caktuar, prej ku lexuesit i bëhet shumë lehtë t'i validojë dhe përforcojë edhe më tej paragjykimet ekzistuese se gratë janë biologjikisht më të prira të mos marrin vendime, apo edhe të ndërrojnë mendje shpesh në krahasim me burrat, të cilët në anën tjetër, sipas po të njëjtës logjikë stereotipike, konsiderohen të vendosur dhe stabil.

Në artikull përmenden gjithsej nëntë deputetë të kësaj partie politike të cilët kanë ndryshuar qëndrim në lidhje me votimin për Gjykatën Speciale. Prej tyre, pesë janë burra, dhe katër janë gra. Megjithatë, artikulli shoqërohet vetëm me fotografitë e dy grave deputete, dhe asnjë fotografi të deputetëve burra.

Në pjesën “Citat”, artikulli përmban citate nga deputetja Teuta Haxhiu dhe analisti Artan Muhaxhiri. Përderisa fotografia e Donika Kadaj-Bujupit mund të arsyetohet me faktin se në këtë kohë ajo mbante post të rendësishëm brenda partisë, përkatësisht atë të shefes së grupit parlamentar, fotografia e deputetes Teuta Haxhiu në këtë rast mund të konsiderohet si vendim i ngutshëm redaktorial, apo si dështim për të marrë parasysh nevojën për prezantim të baraspeshuar të dy gjinive në artikull. Kjo për shkak se në anën tjetër, citatit të sociologut Artan Muhaxhiri nuk i bashkëngjitet asnjë fotografi e tij, më ç'rast artikulli humbet rastin për të dhënë një pasqyrë më të qartë, të baraspeshuar dhe të paanshme nga aspekti gjinor.

Gjakova, përkushtimi e dashuria e Mimozës >

14 E martë, 12 maj 2015
Zeri | www.zeri.info

Intervista

Gjakova, përkushtimi e dashuria e Mimozës

Salih KABASHI / (Gazetar i pavarur)

Mimoza Kusari Lila është shembull i trallë, ndoshta dhe i vetëm i vetëinvestimit total në ngritjen e përparimin e komunës në ballë të së cilës qëndron "Kryetarja që beson në rikthimin e lavdisë së dikurshme ekonomike të komunës së saj". Një qeverisje krejt ndryshe nga qeverisjet e kaluara, moderne dhe efikase, "Gjakovës po i kthehet nami e shkëlqimi i dikurshëm kulturor Fadil Hoxhës do t'i ngritet shtatorja, pos tjerash edhe sepsë për këtë kishte marrë vendim ansambleja e mëparshme komunale".

Gjakova në një të kaluar jo shumë të largët, edhepse brenda një sistemi politik e ekonomik të ngurtë e jo shumë të favorshëm, megjithatë ka pas arritur një zhvillim i cili ishte model jo vetëm për Kosovën, por edhe më gjérë në bashkësinë e atëherëshme...

KUSARI LILA: Kam besimin se mund të përsëritet prespektiva ekonomike kur Gjakova përsëri do të bëhet shembull i një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik.

Deri me tanë Komuna e Gjakovës ka ndërmarrë disa hapa konkret në këtë drejtim, siç janë:

- Zona e lirë ekonomike, parashtrimi i kërkesës Bordit të AKP-së për Parkun e Biznesit;

- Interesimi i investitorëve për të in-

- vestuar në Komunën e Gjakovës;

- Aeroporti i Gjakovës;

- Përpjekjet e vazhdueshme të komunës sonë, si komunë kufitar, me Fondin zhvillimor shqiptar për projekte të përbashkëta me bashkinë vëriore të Shqipërisë, përmirësimi i infrastrukturës, zhvillimi i bujqësisë, potencialet turistike etj..

Të gjithë e kanë të qartë se në çgjendje e keni gjetur qytetin dhe komunën pas fitores suaj në zgjedhjet e fundit. E keni të vështirë të ngritni një qeverisje ndryshe, me cilat rezultate mund të mburreni se i keni arritur dhe cilat janë problemet që ju presin ?

KUSARI LILA: Sfidat më të mëdha dhe problemet e trashëguara pothuajse kemi arritur i t'i tejkalojmë, edhe pse ende përballemi me pasojat e një keqmenaxhim të gjatë në Komunën e Gjakovës. Se kemi ngritur një qeverisje ndryshe, kjo është e dëshmuar tashmë edhe nga vlerësimet që Komunna e Gjakovës merr pothuajse çdo muaj, si:

- komuna e parë e çertifikuar për menaxhimin ISO 2001:2008;



- komuna më transparente nga humutimet e organizatave të ndryshme; - komuna e cila për një vit ka arritur 100% të përbush zotimet për administratë efikase të digitalizuar, duke përfshirë këtu edhe digitalizimin në arsim; - komuna me përfomancën më të mirë në menaxhimin e buxhetit, ku hyn edhe pagesa e mbi 4 milionë eurove borxhe të trashëguara;

- Komuna e cila në mars të këtij viti ka dëshmuar frytet e angazhimit një vjeçar të hapjes së vendeve të reja të punës. (Fabrika Intertex).

Gjakova është një vend i historisë. Një vend i artit dhe i kulturës. Një vend me tradita i piktorëve, muzikantëve dhe posteve. Ia njihni asaj nevojat përmeshtetje materiale e morale ?

KUSARI LILA: Aktivitetet kulturore dhe artistike nga viti 2014, megjithë vështirësitë financiare, tashmë janë rikthyer në Komunën e Gjakovës. Në çdo muaj publikojmë dhe planifikojmë aktivitet e ndryshme, thjeshtë dhe përfundimisht nami kulturor i Gjakovës po rikthehet.

Një debat shumë i zhurmshëm është duke u bërë rreth ngritjes së përmendores se Fadil Hoxhës në vendlindjen e tij. Ju shohim midis dy zjarresh të fuqishëm : njërit për ndërimin e tij, tjetrit për mohimin dhe kategorizimin e Fadil Hoxhës ndër armiqëtë e popullit shqiptar. Ndjej se duhet ta keni vështirë që të kënaqni të dyja palët në kohën kur në kryet Kosovën ende nuk ka një konsensus shoqëror lidhur me të kaluarën tonë jo aq të largët dhe figurat e historisë së sas...

KUSARI LILA: Ne si qeverisje lokale kemi trashëguar një vendim nga asambleja e kaluar për ngritjen e lapidarit të Fadil Hoxhës. Debatin dhe politizimin e kësaj çështjeje e shoh të panevojshëm, përfaktin se kemi historianë të cilët mund ta jepin vlerësimin përfiçur e tij. Pavarejësht komenteve ne si Komunë do të respektojmë vendimin dhe shtatorja e Fadil Hoxhës do të ngritet.

Figura juaj politike, karakteri që ju shquan ka bërë që ju të konsideroheni ndër politikanët më të nnder-

shëm e të karaktershëm në skenën tonë politike, disa zëra ju shohin udhëheqësen e ardhshme të partisë... Kini ndërmend të përqëndroheni edhe në ndonjë mandat në qeverisjen e Gjakovës, apo ambiciet tuaja janë më pretenduese...

KUSARI LILA: Unë postet më të larta i kam lënë për Komunën e Gjakovës, dhe pretendimet pësonale nuk i radhis përpëra interesit të qytetarëve të komunës së Gjakovës. Unë kam fituar besimin e qytetarëve për të bërë ndryshimin, andaj përpëra se të vendosi për një kandidim timin të ri apo diçka që ndërlidhet me të ardhmen time në skenën politike, më duhet të përbush detyrimet e marra përsipër për ndryshimin për Gjakovën.

Gjakova ka një mërgatë të shumtë dhe të kahershme. Keni nisur të nxisni investimet e saj këtu ?

KUSARI LILA: Kam vizituar qytetarët në diasporën tonë në shumë vende. Atje kam nxjortuar interesimin e tyre. Ata atje janë bërë faktorë ndërmjetësimi me shumë kompani serioze të huaja. Me to tashmë kemi filluar negociatat.

Ky artikull i botuar më 12 maj 2015 në gazeten *Zëri* është intervistë e gazetarit me kryetaren e komunës së Gjakovës, Mimoza Kusari-Lila. Intervista, si e tillë, nuk paraqet ndonjë ndryshim apo devijim i cili do të mund të ndërlidhej me gjininë e të intervistuarës. Përderisa kjo analizë nuk ka për synim të vlerësojë cilësinë e pyetjeve të gazetarit apo të intervistës në përgjithësi, duhet theksuar se pyetjet janë profesionale dhe në to nuk vërehet asnjë lloj paragjykimi në baza gjinore. Pyetjet kryekëput kanë të bëjnë me punën e Kusari-Lilës në pozitën e saj të kryetares së komunës.

Megjithatë, pak më problematike janë titulli dhe pjesa hyrëse e tekstit, ku pëershkruhet në pika të shkurtra intervista. “Gjakova, dashuria dhe përkushtimi i Mimozës” ka tendenca patronizuese dhe në të njëjtë kohë përkëdhelëse. Është e vështirë të gjendet ndonjë titull i tillë për një kryetar komune burrë, të cilit titulli do i referohej me emër, e jo me emër e mbiemër apo vetëm mbiemër. Fakti që personazhi kryesor i artikullit është grua bën që autori, me ose pa vetëdije, të marrë rol paternalist dhe ta anashkalojë praktikën e etabluar të referimit me emër e mbiemër të personave që mbajnë pozita të tilla vendimmarrëse. Në anën tjetër, përderisa fjala “përkushtim” është në vetvete term objektiv, e kombinuar me fjalën pararendëse “dashuria”, bën që i tërë titulli të marrë konotacion krejtësisht të ndryshëm. Pikësëpari, vlen të theksohet se është e vështirë të gjendet ndonjë artikull i tillë ku fjala “dashuri” do të përdorej si cilësor i angazhimit dhe punës së ndonjë kryetari të ndonjë komune, apo çfarëdo politikani burrë. Në këtë rast, “përkushtimi” e pëershkruan Kusari-Lilën më shumë si një nënë vetëmohuese, se sa si një politikane profesionale në shërbim të qytetarëve. Edhe pse artikulli promovon një grua politikane dhe i servohet lexuesit si storie e suksesit, ai megjithatë nuk arrin t'u ikë cilësimeve dhe paragjykimeve të caktuara të cilat zbehin, para së gjithash, përmbytjen pozitive dhe profesionale të vetë intervistës.

Kurvat e Shqipërisë, në radhë për tu martuar me pleqtë beqar të Serbisë (Foto-Beograd) >

Kurvat e Shqipërisë, në radhë për tu martuar me pleqtë beqar të Serbisë (Foto-Beograd)

Dhjetëra vajza nga Shqipëria, në Rashkë që të njihen me serbë Agjencionet "Merli 2008" nga Shkodra dhe 'Stara Rashka' nga Beograd kanë organizuar gjatë festës së Vidovdanit një udhëtim për dhjetëra vajza nga rajone të ndryshme të Shqipërisë, të cilat kishin mbërritur në krahinën e Rashkës, në trekufrin Serbi – Mali i Zi – Republika Srpska me qëllim që të njihen me djem të pamartuar serbë nga kjo trevë. Vajzat e



blika Srpska me qëllim që të njihen me djem të pamartuar serbë nga kjo trevë. Vajzat e

ardhura nga Shqipëria kanë dekluaruar se do ta provojnë fatin që të lidhen me ndonjë

djalë serb, nëse ai është ash tu siç duan ato, njoftojnë mediat serbe. Kjo njohje në mes të vajzave nga Shqipëria dhe djemve serbë ka traditë mbi tetë vjeçare dhe për këtë kujdesen agjencione dhe sekserë të specializuar, të cilët menaxhojnë udhëtimet, takimet dhe lidhjet, kuptohet, në kundër vlerë të shumava të caktuara të parave. ■

Artikulli i mësipërm i botuar në korrik të vitit 2014 në gazetën *Bota Sot* mund të konsiderohet shkrim tipik mizogjinist, i dhunshëm dhe i cili haptas nxitë urrejtje. Titulli i artikullit sugjeron se tema e cila shtjellohet është e rëndësishme për lexuesin. Në këtë rast, titulli merr përsipër detyrën për ta tërhequr lexuesin të lexojë për një temë e cila nga redaksia e gazetës konsiderohet apriori joetike, e pështirë, dhe e pavend. Për më shumë, titulli kërkon nga lexuesi konfirmim pothuajse automatik të qëndrimit të përpiluesve të titullit. Me fjalë tjera, autor i titullit supozon se lexuesi medoemos pajtohet me qëndrimin e artikullshkruesit se martesa mes vajzave nga Shqipëria dhe djemve nga Serbia është pa asnjë dyshim e dënueshme dhe e papranueshme.

Analiza fillestare e titullit mund të bëhet duke e ndarë atë në tri pjesë përbërëse të tij, të cilat mund të qëndrojnë si fjali të pavarura bashkërenditëse. Pjesa e parë, "Kurvat e Shqipërisë", u referohet me term tejet përbuzës grave nga Shqipëria. Denominimi "kurvë" në këtë rast është paraqitje e gruas si person i paarsyeshëm, i ligë, dhe agresiv. Në rastin më flagrant, e i cili është përdorur në këtë rast, termi "kurvë" ndërlidhet me konceptin stereotip të moralit, ku autor i artikullit i jep të drejtë vetës të vlerësoje se cilat veprime të grave dhe vajzave janë të moralshme e cilat të pamoralshme.

Pjesa e dyte e titullit, "në radhë për tu martuar", e vendosë institucionin e martesës në një rrafsh ekonomik, të zhveshur nga atributet tjera që ndërlidhen me zhvillimin e marrëdhënieve mes dy personave që arrijnë një kontratë të tillë. Në këtë kuptim, pritja në radhë jep ndjesinë se personi apo personat presin për një shërbim të caktuar kontraktual, i cili zakonisht ka të bëjë me transaksion të mallrave apo shërbimeve. Për më shumë, pritja në radhë nënkuption dëshirën apo nevojën e individit për të marrë atë që do. Në këtë rast, të priturit në radhë është e shoqëruar me fotografinë që paraqet vajzat si dëshpërimisht të pashpresa, dhe të cilat shpresën e vetme e gjejnë tek "pleqtë beqarë të Serbisë".

Pjesa e tretë e titullit, "pleqtë beqarë të Serbisë" është po ashtu e ngarkuar me paragjykime, ku vërehet një diskriminim i dyfishtë – në bazë moshe dhe etnie. Po ashtu shprehet një mospranim pothuajse organik ndaj burrave në moshë më të shtyrë, e të pamartuar. Një bindje e tillë shprehet haptas, përkundër faktit që në artikull nuk jepet asnjë informacion për të elaboruar më tej këtë qëndrim. Në asnjë pjesë të artikullit nuk thuhet se këta persona janë në moshë të shtyrë. Qëllim i vërtetë i një kategorizimi të tillë paragjykues kuptohet më lehtë i analizuar së bashku me pjesën tjetër të kësaj pjesë të titullit, i cili i referohet Serbisë, e që është i ngarkuar me paragjykime nacionaliste. Përpiluesi i titullit nuk e fshehë në asnjë

moment mospajtimin e tij rrëth martesave të grave shqiptare me burrat serbë, duke përdorur edhe përkatësinë etnike për të denigruar dhe poshtëruar një marrëdhënie të caktuar private mes dy personave, siç është martesa.

Fakti që artikulli është i vendosur në fund të faqes dhe është shumë i shkurtër, është në kontradiktë të drejtpërdrejt me "rëndësinë" e cila i jepet kësaj teme përmes titullit. Me fjalë tjera, nëse merret parasysh hapësira e ndarë për artikullin, mund të vihet në përfundim se redaksia e gazetës nuk është e interesuar që artikulli të bie në sy të lexuesit. Për më shumë, titulli e vendos fotografinë e vajzave të reja në një kontekst dukshëm negativ, por nuk ndalet me aq. Duke qenë se titulli së bashku me fotografinë përbëjnë pothuajse 50 për qind të 'moduleve' të këtij materiali (titulli, teksti, fotografia), mund të konkludohet se qëllimi i autorit është që lexuesi ta shohë titullin dhe fotografinë në pothuajse të njëjtën kohë, dhe të vijë në përfundimin e tij/saj pa pasur nevojë ta lexojë tekstin e artikullit.

Përderisa multimodaliteti është praktikë tërësisht normale në media, ku secili nga modulet, titulli, teksti dhe imazhet i japin kuptim materialit të prezantuar, në këtë rast imazhi është tërësisht në shërbim të titullit, dhe nuk sjellë asnjë informatë të re për lexuesin, përvèç që e forcon qëndrimin e shpërfaqur në titull. Për ta bërë tërë artikullin edhe më nxitës, vajzat ne fotografi shihen të qeshura dhe në përgjithësi, në humor të mirë. Është e rëndësishme të theksohet se imazhet që përdoren përkrah tekstit zgjedhen për të dhënë një mesazh të caktuar në pajtim me interesin dhe qëllimin e vetëdijshëm apo të pavetëdijshëm të artikullshkruesit. Me fjalë tjera, vendimi për të përdorur një imazh të caktuar determinohet nga interesi dhe botëkuptimi i personit që vendosë për këtë çështje, si dhe nga gjykimi profesional i personit për fotografinë e cila do të rezonojë më së miri me vlerat dhe botëkuptimet e lexuesit të synuar. Duke qenë se përbajtja e titullit rezonon me vlera të një botëkuptimi të caktuar shoqëror e kulturor vështirë të kontestueshëm, fotografia vendoset në një hapësirë të ngushtë gjykimi, ku qëndrimi mbi moralin e veprimit të këtyre vajzave krijohet para se lexuesi ta ketë mundësinë ta shikojë imazhin nga afër. Si rezultat, vajzat në këtë fotografi gjykohen si individë veprimet e të cilave janë përtrej çdo norme të pranueshme shoqërore e morale, kurse fakti që ato duken në humor të mirë krijon hapësirë për forcim të paragjykimeve paraprake dhe ndjellje të urrejtjes. Për më shumë, vetë fotografia ku shihen fytyrat e këtyre vajzave është dëmtim i drejtpërdrejt i imazhit të tyre.

Në përfundim, mund të thuhet se fakti që artikulli është i vendosur në një qosh të një faqeje të gazetës, na lë të kuptojmë se redaksia nuk synon që artikulli të lexohet edhe aq. Në anën tjetër, nga natyra a titullit, do të ishte pothuajse e natyrshme të pritej që artikulli të zinte një vend më lehtë të dukshëm në faqet e gazetës. Dhe së fundi, teksti i artikullit i cili nuk shtjellon aspak temën e martesave mes vajzave nga Shqipëria dhe aranzhimit të martesave të tilla përmes agjencive private, bën që artikulli të jetë në rastin më të mirë i njëanshëm dhe joprofesional, kurse në rastin më të keq, të ushqejë më tej paragjykimet morale të bëra në kuadër të një sistemi të caktuar vlerash kulturore, si dhe të ndjellë urrejtje ndaj një kategorie të caktuar të statusit martesor, përkatësisht atë të vajzave dhe grave të pamartuara. Është më se e qartë se autori i artikullit nuk ka marrë mundin t'i intervistojë gratë për të cilat shkruhet dhe, edhe pse i pranishëm, teksti i artikullit jep vetëm një pjesë të vogël të gjendjes së përgjithshme. Është më se e dukshme mungesa e përpjekjes serioze nga ana e autorit për ta shtjelluar kompleksitetin e dukurisë së martesave të aranzhuara ndëretnike, dhe shkaqet të cilat i shtyjnë vajzat dhe gratë në martesa të tillë. Duke marrë parasysh të gjitha elementet e këtij artikulli të përshkruara më lart, mund të konkludohet se artikulli është thellësisht joprofesional dhe jo etik, dhe për më shumë, i përbush të gjitha kriteret për ngritje të kallëzimit penal për denigrim imazhi, si dhe diskriminim në baza gjinore dhe etnike.

Si djemtë! >

SPORT

Nga Madridi
në Berlin

Gjegj 25

Futboll Zor për Prishtinën

23

Sport Në Baku me 23 sportistë

23

Basketball Në finale për gjyshen

23



Si djemtë!

Dhuna në sportin kosovar ka ndërruar gjini. Dy ndeshje, njëra në basketboll e tjetra në futboll, janë ndërprerë brenda më pak se një javë, shkaku i përleshjes ndërmjet sportisteve. Palët e akuzojnë njëra-tjetrën, për shkaktimin e dhunës. E njohësit e sportit, kalimin e dhunës nga meshkujt tek femrat, e konsiderojnë dukuri miaft shqetësuese

Artikulli i mësipërm i botuar në gazeten *Zëri* bën një ndërlidhje të drejtpërdrejt mes dhunës dhe përkatësisë gjinore të ushtruesve të dhunës. Edhe pse ka të bëjë më dhunën në sport, gjykuar nga titulli, ky artikull lëshohet në gjeneralizime dhe përforcon stereotipet gjinor, ku burrat (në këtë rast të referuar si djemtë) konsiderohen si të vetmit që janë të aftë për të ushtruar dhunë. Apo shpjeguar ndryshe, artikulli lë të kuptohet se gratë nuk duhet të sillen njëjtë sikurse burrat, duke përforuar më tej stereotipin gjinor se ndjeshmëria dhe vetëpërbajtja janë karakteristika ekskluzive të gruas si qenie biologjike e shoqërore, kurse agresiviteti dhe impulsiviteti karakteristika ekskluzive të burrave. Duke vepruar kësosoj, gazetari i këtij artikulli jo vetëm që nuk arrin t’ia shpjegojë lexuesit këtë dukuri të veçantë nga një këndvështrim objektiv dhe jo domosdoshmërisht krahasues, por përforcon edhe më shumë stereotipin se vetëm burrat janë apo kanë “të drejtën” e të qenit agresiv e të dhunshëm. Përderisa dhuna në terrene sportive tek klubet e vajzave është lajm ekskluziv dhe si i tillë vlen të raportohet, gjykuar nga titulli, artikullshkruesi nuk arrin të raportojë në mënyrë objektive pa i dhënë ngjyrime negative gjinore artikullit.

Në fund, duhet theksuar se analiza e këtij artikulli është e mangët përfaktin se teksti i plotë i artikullit nuk është përfshirë në materialin e mbledhur nga ABGJ-ja dhe rrjedhimisht nuk ka qenë në dispozicion të hulumtuesve të këtij punimi. Teksti i artikullit mund të jetë i balancuar dhe korrekt në prezantimin e grave dhe burrave si dhe roleve të tyre në shoqëri të përcaktuara nga norma të caktuara gjinore e shoqërore. Mirëpo, nëse titulli i artikullit prezanton thelbin e tekstit të plotë të artikullit, atëherë mund të thuhet se ai bie në grackën e prezantimit të grave bazuar në norma e stereotype shoqërore për thyerjen e të cilave do të duhej të kontribuonin më së shumti pikërisht mediat dhe gazetarët.

Qendra ku trajtohen mbi 100 të sëmurë mentalë >

Rajoni

Janë mbi
100 të sëmurë
mentalë ne gjithë
rajonin e komunës
së Skenderajt, të
cilët trajtohen në
Qendrën.

E mërkurë, 17 qershor 2015 | Zeri | www.zeri.info 09

Qendra ku trajtohen mbi 100 të sëmurë mentalë

Në Qendrën e Shëndetit Mendor në Skenderaj thonë se 12 deri në 15 të sëmurë mentalë kanë gjëndrim ditor në qendër, ndërsa të tjerët, rreth 90, marrin terapinë (injekzion) një herë në muaj.

Në qendër trajtohen persona të moshave dhe profesioneve të ndryshme.

Kajtaz Gecaj /Skenderaj

Ishë mësuese me nam, por vrasja e vëllazërvë të saj gjatë luftës e kishte tronditur thellë. E luajtur mendsh, Hyrë Zeka bën një jetë ndryshe nga të sëmurët e tjerë mentalë që trajtohen në Qendrën e Shëndetit Mendor në Skenderaj.

Përdërsa të tjerët mbidhen për çdo ditë në një vend, për ta kaluar ditën dhe për t'u relaksuar dhe për t'u shoqëruar mes vete, mësuesja që e donin të gjithë, rri vetëm. Ata që shkojnë mësojnë edhe për shumë gjëra, nga programet e ndryshme dhe aktivitetet relaksuese, që zbatohen me ta.

Fjali eshtë për rreth 100 të sëmurë mentalë, njerëz me precedentë skizofrenie, nga mosha 18 deri në 65 vjeç, të cilët kanë kaluar nëpër fazë të ndryshme të trajtitimit në Klinikën Psikiatrike në QKU, e të cilët tanë trajtohen në Qendrën e Shëndetit Mendor.

Mbi 100 të sëmurë mentalë, kryesisht skizofrenë, të cilët lirohen nga Klinika Psikiatrike në QKU, vazhdojnë trajtimin në Qendrën e Shëndetit Mendor në Skenderaj, e cila menaxhohet direkt nga Ministria e Shëndetësisë. Sipas stafit të saj, Qendra ofron kushte jashtëzakonisht të mirë të trajtimit për ata persona të cilët janë të regjistruar për qëndrim ditor aty. Por, edhe për të tjerët ka përkujdesje maksimale. Për ata persona me të meta mendore, të cilët trajtohen me qëndrim ditor në Qendër, sigurohet edhe një racion ushqimi.

Të sëmurë që më parë janë trajtuar në QKUK

Shqipe Feka, një prej infermierive që punojnë në këtë Qendër, dhe e cila ka detyrën e përgjegjëses, thotë se për personat e sëmurë mentale janë siguruar ekipe mobile, të cilat dalin në terren dy herë në javë dhe i takojnë të gjithë të sëmurët mentalë. Ajo shton se me personat me qëndrim ditor, krahas aktivitetave të ndryshme, organizohet edhe shoqërimi në grup dhe me ta dilet edhe jashtë objekti të Qendrës.



Qendra e Shëndetit
Mendor në Skenderaj



Mësuesja Hyrë Zeka,
tani e sëmurë mendor

Fakte

Shqipe Feka, një prej infermierieve përgjegjëse në Qendrën e Shëndetit Mendor në Skenderaj, thotë se për personat e sëmurë mentalë janë siguruar ekipe mobile, të cilat dalin në terren dy herë në javë dhe i takojnë të gjithë të sëmurët mentalë. Ajo shton se me personat me qëndrim ditor, krahas aktivitetave të ndryshme, organizohet edhe shoqërimi në grup dhe me ta dilet edhe jashtë objekti të Qendrës.

programmit psiko-social, të cilin e zbatojnë njerëz profesionalë që vijnë nga qendra në Mitrovicë, pjesë e të cilës është Qendra e Shëndetit Mendor në Skenderaj, por edhe stafi i Qendrës përkujdeset për aktivitetet relaksuese me të sëmurët mentalë", thotë Feka. Sipas saj, ata janë të sëmurë, të cilët më përpërajanë trajtuar në klinikë, janë të sëmurë që janë trajtuar nga skizofrenia dhe tani trajtin e vazhdojnë këtu.

"Janë mbi 100 të sëmurë mentalë në gjithë rajonin e komunës së Skender-

ajt, të cilët trajtohen në Qendër. Derisa 12-15 prej tyre, e nganjëherë edhe më shumë, sidomos në ditët kur vijnë përmarrë terapiat, të tjerë rreth 90, marrin terapinë këtu në gendër, një herë në muaj", thotë infermierja Shqipe Feka, e cila shton se ata marrin terapinë në formë injeksioni.

Ajo nuk ka veçuar ndonjë rast të pakëndshëm, pas që Qendra ka të bëjë me njerëz që edhe mund të janë të rrezikshëm, para së gjithash përfshin, por ka ripërsëritur se trajtimi i të gjithë të sëmurëve mentalë në komunën e Skenderaj bëhet në mënyrë profesionale.

Për mësuesen Hyrë qytetarëve u dhemb shpirti

E të sëmurët janë të moshave dhe të profesioneve të ndryshme. Në mesin e atyre, përtë cilën qytetarëve të Skenderajt u dhemb shpirti, është edhe një mësuese me nam, te e cila mësuesi pothuaje të gjithë prindër përti i regjistruar fëmijët e tyre. Dhe nuk e kishin të gjithë fatin që fëmijët t'i regjistrojnë të mësuesja Hyrë,

sepse në një paralele, atëherë mund të mësonin më së shumti 40 nxënës.

Fati i keq ka dashur që ajo të sëmurej pak kohë pas përfundimit të luftës, si posojë e traumave të mëdha gjatë luftës, sidomos pas vrasjes së vëllazërvë të saj në luftë. Shenjat e para të çrrëgullimit psikik kolegët e mësueses Hyrë i kishin vërejtur menjëherë, por ajo vazhdonte t'i edukonte nxënësit në shkollën "Shaban Jashari" edhe përgati dy vjet pas përfundimit të luftës. Drejtoria e Arsimit në Skenderaj ishte detyruar që t'a ndëpriste marrëdhënien e punës, por pagën ia dërgonin. Komuna u përkujdes që t'a jepte edhe një banesë, por kjo ishte e tërë. Për shërimin e saj, nuk ishte përkujdesur askush. E lënë krejtësisht vetëm, sëmundja e mësueses Hyrë bëhej gjithnjë e më e madhe. E tanë, kur sëmundja e rëndon, mësuesja Hyrë nga balkoni i banesës së saj, i therrët nxënësit e vet, madje edhe kolegeve të dikurshme të saj u sugjeron se qfarë të bëjnë me nxënësit. E gjithë kjo gjindje e saj, shkakton dhembje te qytetarët e Skenderajt, sidomos te ata që mësuesen Hyrë e kanë njojur ndryshe nga që është sot.

Ky artikull i botuar më 17 qershor të vitit 2015 në gazetën *Zëri* flet për Qendrën e Shëndetit Mendor në Skenderaj ku, sipas artikullit, trajtohen 100 të sëmurë mendorë. Për ndryshim nga artikujt e analizuar më lartë, në këtë artikull titulli dhe pjesa hyrëse kryejnë funksionin e tyre në mënyrë objektive dhe informuese. Në titull tregohet se në këtë qendër trajtohen më shumë se 100 persona me sëmundje mendore, kurse në hyrje jepen disa detaje kyçë në lidhje me numrin e pacientëve, si dhe faktin se në qendër trajtohen persona te moshave dhe profesioneve të ndryshme.

Në këtë artikull, është e qartë se gazetari ka vendosur ta tregojë storien përmes njërit prej pacientëve, e cila në këtë rast është grua. Shpjegimi i një dukurie të përgjithshme përmes një rasti të përveçëm është teknikë e njohur në shkrimet gazetareske dhe mjaft efikase në shpjegimin e dukurive dhe temave të ndërlikuara shoqërore. Shkrime të tillë kanë fuqinë të krijojnë lidhje emocionale mes lexuesit dhe protagonistit të stories, duke bërë që lexuesi ta analizojë çështjen në fjalë nga këndvështrimi i protagonistit. Megjithatë, në shkrime të tillë, është po aq e rëndësishme që protagonistit t'i jepet hapësira e duhur që vetë ai/ajo ta tregojë ngjarjen. Me fjalë tjera, shkrime të tillë janë më të suksesshme atëherë kur gazetari është pothuajse i padukshëm, dhe lexuesi ka ndjenjën se është në bashkëbisedim të drejtpërdrejt me protagonistin, i papenguar nga prania e gazetarit në rolin e ndërmjetësuesit.

Në artikullin në fjalë, gazetari fillon duke përshkuar protagonisten kryesore, Hyrë Zekën. Gazetari tregon se protagonistja e shkrimit ka qenë mësuese, para se të shfaqte shenjat e para të sëmundjes mendore e cila, sipas autorit, kishte ardhur si pasojë e vrasjes së vellezërve të saj gjatë luftës në Kosovë. Duhet theksuar se gazetari nuk është as për afërm i kualifikuar të vërtetojë se vrasja e vellezërve ka qenë shkaktari i sëmundjes. Një sqarim i tillë do të ishte i besueshëm dhe valid vetëm në rast se do te jepej nga një profesionist i fushës, përkatësisht mjeku i protagonistes, e i cili do të citohej në artikull.

Fillimisht, është e rëndësishme të theksohet se në shkrime të tillë është në diskrecion të gazetarit të vendosë se cili individ është më i përshtatshëm për ta ndriçuar një dukuri të përgjithshme përmes tregimit personal të tij apo saj. Problemi me këtë artikull qëndron në faktin se protagonistja e zgjedhur nuk është shembull ilustrues i temës e cila shtjellohet dhe kriteri i vetëm që ajo përbush është fakti se është një nga 100 pacientët që trajtohen rregullisht në këtë qendër. Për më shumë, nuk është e qartë nëse gazetari dëshiron të shkruajë për nevojën e ofrimit të shërbimeve psiko-sociale për trajtimin e traumave të të mbijetuarve të luftës, apo dëshiron të na paraqesë tregimin e veçantë të një individit të caktuar. Cilido të ketë qenë qëllimi i gazetarit, në të dyja rastet mund të thuhet se përpjekja e tij është gjysmake dhe artikulli nuk bën thirrje as për përmirësimin e ndihmës psiko-sociale nga ana e institucioneve, e as nuk paraqet ndonjë tregim unik të protagonistes së shkrimit. Gjykuar nga përbajtja e tekstit, mund të konkludohet se tregimi për protagonisten është zgjedhur vetëm si shtojcë e raportimit mbi punën e qendrës, e jo si element kryesor i cili i jep drejtim dhe fuqi shpjegimit të trajtimit të sëmurëve mendorë në këtë institucion.

Gazetari e përshkuar protagonisten e shkrimit si një ish-mësuese "me nam", tanë "e luajtur mendsh", për të cilën "qytetarëve u dhemb shpirti". Por të gjitha këto përfundime i nxjerr vetë autori, pa përfshirë në artikull persona të cilët do të mund të tregonin drejtpërdrejt për historinë e saj (familjarë, miq, ish-kolegë), dhe llojin e sëmundjes (mjekët). Edhe më brengosës është fakti se protagonistja nuk flet as edhe njëherë të vetme gjatë gjithë artikullit. Kjo jep përshtypjen se autori shkruan për te në bazë të njohurive të përgjithshme personale dhe të informatave rrëthanore e subjektive, pa marre mundin që t'i japë hapësirën e domosdoshme personit i cili bartë barrën kryesore të artikullit ta tregojë historinë e saj. Mos marrja eventuale e pëlqimit për të qenë pjesë e një artikulli në gazetë nga personi që

prezantohet në storie, si dhe përdorimi i emrit dhe mbiemrit si dhe fotografisë pa pëlqimin e tij/saj, paraqet anashkalim serioz të parimeve bazike të raportimit objektiv dhe etikës profesionale.

Në përgjithësi, artikulli ka tone të theksuara të raportimit deskriptiv, cili para së gjithash bazohet në perceptimet e gazetarit, dhe jo në pasqyrimin serioz të gjendjes fizike, psikike e shpirtërore të një sëmuri mendor. Në anën tjetër, fotografia e saj përshkruhet si vijon: "Mësuesja Hyrë Zeka, tanë e sëmurë mendore". Përveç që nuk ofrohet asnje detaj specifik në lidhje me veçantitë e sëmundjes së saj dhe ndikimin e saj në jetën e pacientit, ky përshkrim është joprofesional dhe përjashtues, pasi që e redukton protagonisten në vetëm dy role - ose si mësuese, ose si e sëmurë mendore - të cilat, sipas autorit e përjashtojnë njëra tjetrën. Në këtë rast, autori reflekton qasjen tejet subjektive dhe ndikimin e theksuar nga norma të caktuara shoqërore, te cilat në njëren anë profesionin e mësuesit e shohin si diçka fisonike, kurse në anën tjetër i stigmatizojnë sëmundjet mendore. Gazetari e vendosë padrejtësish personalitetin e protagonistes në mes te këtyre dy ekstremeve, me ç'rast nuk lë hapësirë për krijim te opinionit objektiv e të pandikuar nga ana e lexuesit. Artikulli po ashtu shkelë parimet e Ligjit kundër Diskriminimit, si dhe të drejtën e pacientit për privatësi.

Teuta në LDK sjell vota dhe vlera >

VIZITOJENI EDHE ONLINE
WWW.BOTASOT.INFO

AKTUALE

Jehona e kandidimit të Teuta Rugovës në LDK

Teuta në LDK sjell vota dhe vlera

"Unë them që të paktën 20 apo 25 mijë vota do i marr zonjusha Teuta Rugova dhe gjithsesi në përqindjen gjenerale do të ndikoj në ngritjen e LDK-së", thotë për "Bota sot", analisti Jeton Kelmendi.

Kelmendi, vlerëson se kontributi i Teutës është shumë i madh për LDK-në dhe ngritjen e eklatoriat saj.

Mimozë Lakna

Kandidati i Teuta Rugovës për deputetë në Kuvendin e Kosovës po konsiderohet si hap pozitiv për Lidhjen Demokratike të Kosovës.

Përvec, se është ndër kandidatët më të rinj përeputë, Teuta Rugova është edhe vajza e presidentit Ibrahim Rugova i cili themeloi Lidhjen Demokratike të Kosovës. Si subjekti i politikës në Kosovë i cilin e shpejtua përdorur e shqiptarëve.

Teuta Rugova iu bashkua LDK-së, përfshirë përqafues të rinxje të Kosovës. Përvec, kësaj, me kandidimin i saj për deputetë po vlerësohet si gë pothive edhe sa i përket numrit të votave që mund i arrji LDK-ja në këto zgjedhje.

"Mendoj se cdo ardhje cilësore në LDK ka një kuptim pozitiv për këtë subjekt politik, sepse në këtë mënyrë shenon edhe rritje në eklator. Kësajso aderimi i gocës së presidentit Rugova në LDK mendoj se do të fitonte një përqindje me të ulet dha vlerështat që Teuta është politikë e positiivë, që e ka qenë shumë e mirë se vellai i saj Uka, i cili nuk i ka shkaktuar aq sa duhet në Kuvendin e Kosovës.

"Në jam shumë i bindur që do të jem shumë më e mirë se i vellai se pëndoshës i shumku mund të jetë zhgënjyer me plotësisht të drejtë se pëse Uka ka qenë deputet aktiv gjë që është konstatuar nga shumë OQ. Kjo nuk ka arsy që të jem mështer nga Uka, që është më i madh i ndiqshëm, por qëllë dëshmi e urtë. Këshin dohet se i ka ngjarë më potenciale që përfshin Rugova", potencën Kelmendi.

Gjatë prezantimit të saj si kandidate për deputetë, Teuta Rugova tha se LDK-ja, që nga filimi i saj është bërë sinonim për liri dhe pavarezi.

"Duhet mbështetur edhe iniciativa e kryetarit Mustafa për të shkuar në shqipshirë që t'i konsiderohet i shumë i madhi i Kosovës i nevojitet forcë dhe artikulonje që dëshmojnë përfshirë jetë popullit përfshirë lirin, pavarësi dhe demokraci, pra LDK-ja që nga filimi i saj është bërë sinonim i lirës pavarësine dhe demokracisë. Apo së ka thënë

te ulet dha vlerështat që Teuta është politikë e positiivë, që e ka qenë shumë e mirë se vellai i saj Uka, i cili nuk i ka shkaktuar aq sa duhet në Kuvendin e Kosovës.

Ajo tregoi se tashmë ka mbaruar studimet universitare dhe sipas saj, tanë është shumë e nevojshme që riñja të përfshojet në mënyrë të denjë krah për krah me vlerat dhe cilësizmin evropian.

Ajo ka vendosur që t'i boshkohet LDK-së, vçancenist përfshirë përfshirështet e rinjët dhe femrat e Kosovës.

"Tanë që e kam mbaruar universitetin, mendoj që është më se më pak i përfshirë që t'i boshkoj LDK-së, që t'i boshkoj këtë një përfshirështet e denjë në Kuvendin e Kosovës, sepse segmenti i shoqërisë shqiptar edhe shtë anashkakus i na platin e brendshëm, që i harruar i izoluar në planin ndërkombëtar. Të rinxje tanë duan të jenë krahë për krahë me moshatarët e tyre evropian, t'i ndajni dhe t'i gjëzojnë vlerat e tyre të civilizimit evropian", thosken Teuta.

Kandidimin e saj për deputet e kanë mirepritur edhe kryerët e LDK-së, të cilët kanë thënë se Teuta do të jetë përfshirësue e denjë e zërit të rinisë në Kosovë. ■

Kombëtare

12 maj 2014 | Ed. Shkodra

BOTA SOT

A do hyjnë AKR-ja dhe PD-ja në koalicion me LDK-në?

KATËR RISITË E LDK-SË TË HËNËN DORËZUHEN EMRAT E KANDIDATEVE PËR DEPUTET

Teuta rrugës së babait, 'LDK-ja për popullin është shpresë dhe besë'

Teuta Ibrahim Rugova, hyjnë garën zgjedhore. Faqja 03

Artikulli i mësipërm i botuar më 12 maj të vitit 2014 në gazetën *Bota Sot* ka të bëjë me anëtarësimin e Teuta Rugovës, vajzës e ish-presidentit të ndjerë Kosovës dhe ish-kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovë (LDK), Ibrahim Rugova, në radhët e LDK-së. Fotografia e përdorur dhe titulli i artikullit janë objektiv dhe e paraqesin protagonisten në mënyrë objektive dhe pozitive.

Një nga problemet madhore të këtij artikulli është dhënia e një hapësire mjaft të madhe për njërin nga analistët politik. Në fakt, artikulli bazohet pothuajse tërësisht në qëndrimet dhe opinionet e këtij analisti për ta dhënë lajmin e anëtarësimit të protagonistës në LDK. Për më shumë, artikulli mëton të shpjegojë se si LDK-ja do të përfitojë nga anëtarësimi i Rugovës në radhët e saj. "[...] aderimi i gocës së presidentit Rugova në LDK mendoj se do të ndikoj pozitivisht për vet faktin se është bija e një personaliteti shumë të fuqishëm dhe natyrisht se do të ndikoj që të marrë vota." Analisti politik më tej vazhdon duke thënë: "Unë them që të paktën 20 apo 25 mijë vota do i marr zonjusha Teuta Rugova dhe gjithsesi në përqindjen gjenerale do të ndikoj në ngritjen e LDK-së". Në pjesën e parë të këtij citati, analisti politik i drejtohet protagonistës me termin "gocë" dhe aftësinë e saj përfshirë fituar vota e ndërlidh drejtpërdrejt me faktin se është "e bija" e ish-presidentit Rugova. Në pjesën e parë të citatit, Rugova përshtakuhet me termin "gocë", që në përgjithësi ka konotacion përkëdhësë e ledhatues dhe përshtkuar një vajzë të moshës së re, kurse në pjesën e dytë përdoret fjala "bijë", e cila përfshirë dallim nga termi "gocë", vë në pah më shumë aspektin e familjes,

marrëdhëniet “babë e bijë”, të përshkuar me një dozë konsiderate për vlerat e familjes dhe rolin e gruas brenda saj.

Artikulli vazhdon më tej me citatin e analistit, ku thuhet se “[...] duhet përshëndetur [anëtarësimin e saj] sepse është gocë e re dhe kryja në politikë sigurisht është pozitive aq më tepër kur ajo është e përgatitur sepse ka mbaruar edhe studimet”. Në këtë pikë, analisti në fjalë e sheh të udhës ta përmend faktin që protagonistja ka përfunduar studimet, duke shpërfaq që kështu një dozë të hollë të diskriminimit gjinor, ku përfundimi i studimeve përnjëherë konsiderohet si kriter i rëndësishëm për aktivitet politik. Në aspektin e dhënies së një informate shtesë, një gjë e tillë është plotësisht e pranueshme dhe korrekte, por duke qenë se një kriter i tillë rrallëherë, apo ndoshta asnjëherë nuk konsiderohet i rëndësishëm apo komentohet për djemtë e rinj në politikë, dëshmon se analisti ndjen nevojën për ta dëshmuar se protagonistja, edhe pse vajzë e re, është e denjë për anëtarësim në parti. Një standard i tillë i dyfishtë vërehet edhe në vazhdim të artikullit, kur analisti thotë se protagonistja e shkrimit do të jetë “shumë më e mirë se i vëllai”, duke iu referuar Ulë Rugovës të anëtarësuar në LDK disa vite më parë, “sepse Uka ka qenë deputet joaktiv [...] Ajo [Teuta Rugova] duket më dinamike, më e gjallë, dhe më e urtë. Kështu duket se i ka ngjarë më shumë presidentit Rugova”. Në fjalinë e parë analisti vendosë protagonisten në rrafsh krasues me vëllain e saj, edhe pse lexuesit nuk i jepet asnjë informatë për vëllain e saj në bazë të të cilës do të mund të arrihej deri te një konkludim se pse ajo ka gjasa të jetë më e suksesshme së vëllai i saj. Në vazhdim, ajo cilësohet si dikush që i ka ngjarë babait të saj, duke u munduar ta bindë kështu lexuesin, e sidomos përkrahësit e LDK-së, se ajo, në masë të madhe, e meriton votën e tyre pikërisht për shkak të këtij fakti. Protagonistes nuk i ofrohet mundësia te shprehë përgatitjen e saj si kandidate e ardhshme, apo programin e saj politik. Ajo diskriminohet që në fillim, pasiqë nuk i ofrohet mundësia ta shprehë bagazhin personal të njojurive, por e vë në pozitë krasimi me babanë dhe vëllain. Është e rëndësishme që edhe individëve që marrin pjesë për herë të parë në garë zgjedhore t'u ofrohet mundësia ta shprehin potencialin e tyre personal e akademik, qofshin burra ose gra, pavarësisht origjinës familjare, nationale, sociale etj. Duke mos e bërë një gjë të tillë, ky shkrim kontribuon në dëmtimin e profilit personal politik të protagonistes si një kandidate e re e cila mund të ofroj vizion te ri.

Artikulli është po ashtu i njëanshëm për shkak se mundohet ta paraqesë protagonisten në mënyrë sa më të mirë të mundshme, paçka që autorja së bashku me analistin e intervistuar, me ose pa vetëdije, jo gjithmonë japid cilësimë pozitive. Për më tepër, është brengosës fakti se përveç analistit dhe vetë protagonistes citatet e së cilës paraqiten vetëm në fund, artikulli nuk ka një zë të tretë, qoftë edhe atë të vetë gazetares, i cili do të ofronte një baraspeshë mes raportimit mbi anëtarësimin e saj në LDK, në njëren anë, dhe rritjen e LDK-së si parti politike, në anën tjetër. Thënë ndryshe, artikulli ka shumë më të përbashkëta me një vështrim personal, se sa me raportim të pavarur e objektiv.

Ermira Mehmeti kërkon më shumë vëmendje për Maqedoninë nga Tirana e Prishtina >

e mërkurë • 28 maj 2014

arbëri

KOHA Ditore • 7

DEPUTETJA E BDI-SË KA FOLUR PËR GJENDJEN E SHQIPTARËVE NË MAQEDONI PARA STUDENTËVË TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"

Ermira Mehmeti kërkon më shumë vëmendje për Maqedoninë nga Tirana e Prishtina

"Duhet një vëmendje më e madhe nga ana e Kosovës dhe e Shqipërisë për politikën, por edhe ngjarjet në Maqedoni, në veçanti nga Shqipëria si shtet amë, sepse shqiptarët në Maqedoni me kushtetutë përcaktohen si pjesë e popullit shqiptar që jeton në Maqedoni", ka thënë Ermira Mehmeti

Uran Krasniqi

PRISHTINË, 27 MAJ — Deputetja më e votuar shqiptare e Kuvendit të Maqedonisë, Ermira Mehmeti, ka kërkuar vëmendje më të madhe për shqiptarët e Maqedonisë nga ana e Tiranes dhe e Prishtinës.

Teksa e ka mbajtur një ligjëratë, të martën, në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", ku temë diskutimi ka qenë pozita e shqiptarëve në Maqedoni, deputetja e Bashkimit Demokratik për Integrin, ka thënë se për vëmendje meqijthatë Tirana ka më shumë obligim sesa Prishtina. "Duhet një vëmendje më e madhe nga ana e Kosovës dhe e Shqipërisë për politikën, por edhe për ngjarjet në Maqedoni, në vegantë nga Shqipëria si shtet amë,

sepse shqiptarët në Maqedoni me kushtetutë përcaktohen si pjesë e popullit shqiptar që jeton në Maqedoni. Shqipteria duhet të jetë pak më syçelë, Kosovës nuk besoj që i takon brezit që vjen, zgjedhin të mësojnë nga lidérat e tyre që janë pozitive, por anët konfliktueze". Sipas saj, mos të qenit në një linjë në situata të caktuarështë për keqardhje. "Nuk mund të them se vetëdija jonë politike, partitë në qeveri, kanë përgjegjësi dhe detyrë përsore që në vazhdimisë sa që të kuptojnë që përmes tema të caktuarës duhet të gjemjë guximin dhe të sillemi në përgjegjësi dështimi i tij të bashkuar dështimi i tij të bashkëpunojnë. Paradoksi i absolutistëve sistemin tonë politikë janë gjithandje dështimi i tij të shprehjë në vazhdimisë, por disi gjemjë mënyrat e mekanizmat përfundueshmëri të rrujshëm së shqiptarët që nuk mund të eliminohen", ka thënë deputetja shqiptare.

"Unë besoj se Maqedonisë i duhet një freskin në kuptimin e lidereve politikë shqiptarë, sepse është e parashueshme që në rrënë e evropianizimit nuk akoma të shërbimehi me retorikën e vjetëve ndërtimët, të merremi atë se kush ka qenë spin i UDB-së, kush kujt ia ka bërë gropën e varrin e kështu me radhë". Sipas saj, këto lloj arkazmash politikë të përkasin një koherë të shkuan me tij, ajo nuk identifikohet. "Sot politika, të bërit politikë, imponon dhe kërkon prej nesh disa vlera të tjera që disa politikanë në

politikanëve të një brezi pak më të shkuan dite atyre që vijnë", ka thënë ajo. "Për fat të këq, edhe këta të fundit, politikanët që duhet t'i përkasin brezit që vjen, zgjedhin të mësojnë nga lidérat e tyre që janë pozitive, por anët konfliktueze". Sipas saj, mos të qenit në një linjë në situata të caktuarështë për keqardhje. "Nuk mund të them se vetëdija jonë politike, partitë në qeveri, kanë përgjegjësi dhe detyrë përsore që në vazhdimisë sa që të kuptojnë që përmes tema të caktuarës duhet të gjemjë guximin dhe të sillemi në përgjegjësi dështimi i tij të bashkuar dështimi i tij të bashkëpunojnë. Paradoksi i absolutistëve sistemin tonë politikë janë gjithandje dështimi i tij të shprehjë në vazhdimisë, por disi gjemjë mënyrat e mekanizmat përfundueshmëri të rrujshëm së shqiptarët që nuk mund të eliminohen", ka thënë deputetja shqiptare.

"Unë besoj se Maqedonisë i duhet një freskin në kuptimin e lidereve politikë shqiptarë, sepse është e parashueshme që në rrënë e evropianizimit nuk akoma të shërbimehi me retorikën e vjetëve ndërtimët, të merremi atë se kush ka qenë spin i UDB-së, kush kujt ia ka bërë gropën e varrin e kështu me radhë". Sipas saj, këto lloj arkazmash politikë të përkasin një koherë të shkuan me tij, ajo nuk identifikohet. "Sot politika, të bërit politikë, imponon dhe kërkon prej nesh disa vlera të tjera që disa politikanë në



Foto: Driton Pajazda

Teksa e ka mbajtur një ligjëratë, të martën, në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", ku temë diskutimi ka qenë pozita e shqiptarëve në Maqedoni, deputetja e Bashkimit Demokratik për Integrin, Ermira Mehmeti, ka thënë se për vëmendje meqijthatë Tirana ka më shumë obligim sesa Prishtina

jës që vërtet nësë dëshirojnë që të shpëtojnë vendin nga situata të tilla që mund të bëhen më dramatike, të ulen dhe të punojnë më seriozisht në agjendën integruuese, gjegjësisht në zgjidhjen e çështjes së emrit të shtetit të kontestuar nga Greqia.

Mehmeti ka thënë se ndër problemet kryesore të shqiptarëve në Maqedoni është përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe.

Ajo ka thënë se fuqitë e mëdha pavareësish pengesave të shumta nga shtetet e tjera përfresh nuk do të lejojnë që shteti i Maqedonisë të prishet, megj. sipas saj, me atë rast do të hapej "Kutia e Pandorës".

"Mungesen e Xhaferit më së shumti po e vuan PDSH-ja"

Deputetja e BDI-së, Ermira Mehmeti, ka thënë se shqiptarët në Maqedoni, por më së shumti Partia Demokratike Shqiptare, po e vuajnë mungesën e intelektualit, filozofit dhe publicistik, Arben Xhaferi. "Sai i përket mungesës se Arben Xhaferit unë besoj se bëhet fjale për një intelektual të etabluar të dhëshmuar të realizuar që gjëzonë respektin e opiniionit publik gjithandje në trevat shqiptare dhe jo vjetëm. Gjithsesi që është një humbje për të gjithë shqiptarët", ka thënë ajo. "Natyrish se ndihet mungesa e tij dhe unë besoj që më së shumti e ndien strukturën politike të cilën e ka drejtuar për shkak se që nga largimi i tij kjo strukturë politike duket se është në një krizë politike e cilë pas refuzuar edhe në mënyrën se si vepron PDSH-ja".

Deputetja e BDI-së, Ermira Mehmeti, ka thënë se shqiptarët në Maqedoni, por më së shumti Partia Demokratike Shqiptare, po e vuajnë mungesën e intelektualit, filozofit dhe publicistik, Arben Xhaferi. "Sai i përket mungesës se Arben Xhaferit unë besoj se bëhet fjale për një intelektual të etabluar të dhëshmuar të realizuar që gjëzonë respektin e opiniionit publik gjithandje në trevat shqiptare dhe jo vjetëm. Gjithsesi që është një humbje për të gjithë shqiptarët", ka thënë ajo. "Natyrish se ndihet mungesa e tij dhe unë besoj që më së shumti e ndien strukturën politike të cilën e ka drejtuar për shkak se që nga largimi i tij kjo strukturë politike duket se është në një krizë politike e cilë pas refuzuar edhe në mënyrën se si vepron PDSH-ja".

Artikulli i mësipërm i botuar më 28 maj të vitit 2014 në gazeten Koha Ditore, është një shembull pozitiv i raportimit objektiv, të pavarur e profesional. Protagonistja kryesore e artikullit është Ermira Mehmeti, deputete shqiptare në Kuvendin e Maqedonisë. Artikulli mbulon një ligjëratë të mbajtur nga Mehmeti në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".

Titulli i artikullit sqaron pa asnjë ngjyrim apo qëllim tendencioz thelbin e ligjëratës, kurse pjesa hyrëse, përmes citatit të drejtëpërdrejtë, zgjeron edhe më tej çështjen kyçë të diskutuar nga protagonistja e artikullit gjatë mbajtjes së ligjëratës. Në fillim të artikullit, si pjesë e dhënes së informatave bazike mbi te, gazetari i njofton lexuesit se Mehmeti është deputetja shqiptare më e votuar shqiptare e Kuvendit të Maqedonisë. Fotografia e përdorur është fotografi origjinale e cila paraqet protagonisten gjatë mbajtjes së ligjëratës. Në përgjithësi, artikulli është shembull i mirë i raportimit të balancuar e objektiv, i cili nuk lëshohet në cilësimë të pavenda dhe tendencioze, e që do të mund të ndërlidheshin me faktin që protagonistja e artikullit është grua. Përkundrazi, përmes raportimit të paanshëm, ky artikull paraqet Mehmetin në pozicionin e saj natyral në jetën publike, në atë të një gruaje politikane të suksesshme në skenën politikë të Maqedonisë, dhe në skenën politike shqiptare në përgjithësi. Përmes artikullit, protagonistës i ofrohet mundësia që ta shprehë bagazhin e saj

politik, si dhe njohuritë profesionale mbi skenën politike në Maqedoni. Për më shumë, shkrimi e paraqet atë si një politikane me vizion të qartë për të ardhmen e Maqedonisë, dhe e bën këtë përmes paraqitjes së opinionit që ajo ofron mbi rolin, pozitën dhe mundësitetë politike të Maqedonisë, rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE dhe NATO, si dhe rolin e Kosovës dhe Shqipërisë në raport me shtetasit shqiptarë të Maqedonisë.

Kadriu thotë se hyri në PDK për t'ua kthyer buzëqeshjen qytetarëve >

DREJTORESHA DHE KRYEREDAKTORJA E "KOSOVËS SOT", MARGARITA KADRIU, ADERON NË PDK

Kadriu thotë se hyri në PDK për t'ua kthyer buzëqeshjen qytetarëve

Uran Krasniqi

PRISHTINË, 14 MAJ - Margarita Kadriu nuk është më drejtoreshë e kryereditore e gazetës "Kosova Sot".

Këto pozita ajo i ka zëvendësuar me atë të nënkyretares së Partisë Demokratike të Kosovës.

Kadriun, si prurjen më të re të PDK-së, e ka prezantuar të mërkurën kryetari i kësaj partie, njëherësh kryeministër në detyrë, Hashim Thaci.

"Sot kam kënaqësinë e veçantë që të mirëpres në ekipin fitues të PDK-së zonjën Margarita Kadriu. Margarita është një vlerë intelektuale, që i bashkohet PDK-së dhe politikës shtetërore të vendit jo për t'i marrë, por për t'i dhënë asaj përvojën e suksesit të saj. Zonja Kadriu i bashkohet misionit të ri fitues, misionit për zhvillim ekonomik dhe punësim", ka thënë Thaci. "Zonja Kadriu do ta ketë hapësirën e mjaftueshme edhe si nënkyetare e PDK-së, ashtu edhe në ekipin e ardhshëm qeverisës në funksion të zhvillimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të reja të punës, si dhe rrjetes së mirëqenies sociale të qytetarëve të Kosovës".

Ai ka treguar se si ka ndodhur që Kadriu të bëhet nënkyetare e par-

tisë. "Ne e kemi edhe në statutin tonë të drejtën e kooptimit, kështu që ka qenë vendim i organeve drejtuese të partisë", ka thënë Thaci. Ai e ka quajtur PDK-në lëvizje që, sipas tij, është më shumë sesa parti. "Ardhjet dhe prurjet në PDK nga shqëria civile, komuniteti i biznesit, mediat dhe partitë e tjera politike, janë realisht prurje të pastrat të forcimit të PDK-së dne nuk janë riciklime sikur që po ndodh me subjektet e tjera, ku edhe kanë librezë e edhe shkojnë e dalin në konferencë për shotyp", ka thënë Thaci. "Kështu që, ardhjet dhe prurjet tonë janë substanciale nga bota civile, akademike, e biznesit dhe mediale".

Kadriu në fjalën e saj ka thënë se nuk po hyn në PDK për fotele, por për qytetarët e Kosovës. "Arsyeja që po hyj në politikë nuk është që unë ta kem një fotele, se fotelën e kam pasur mbi shtatëmbëdhjetë vjet. Unë po hyj për qytetarët e Republikës së Kosovës. Unë po hyj, po e sakrifikoj pjesën e karrierës sime në biznesin privat, për të kontribuuar. Nuk po hyj që të marr një fotele, të cilën veç e kam, e të cilën po e dorëzoj", ka thënë ajo. "Prej sot unë nuk jam pjesë e statit të gazetës "Kosova Sot". "Kosova Sot" nuk është hapur para gjashtëmbëdhjetë vjetëve që të hyjë Margarita Kadriu në politikë,



Foto: Alban Bujari

Margarita Kadriu ka thënë se nuk po hyn në PDK për fotele, por për qytetarët e Kosovës

"Kosova Sot" e ka misionin e vet, informimin e mirëfilltë, gjithmonë përfundimtar, por gjë më tanë të munguar, dua t'ua kthej shpresën dhe besimin bashkë me buzëqeshjen, në ftyrat e qytetarëve të Kosovës", ka thënë ajo. "Pra, fokusim kryesor do të jetë zhvillimi i hovshëm ekonomik bashkë me sigurinë dhe sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës", ka shtuar ajo. Kadriu ka thënë se arsyetet e shtë që ojo po synon të ofrojë një model të ri të politikanit, që, sipas saj, konkretisht i përvjet mëngët dhe jep maksimumin e aftësive që i ka, që përdor kokën e dijen e vet.

© KOHA Ditore

pas zgjedhjeve të qershoret, duke sjellë dhe duke bërë ndryshimin përbajtjesor, por gjë më tanë të munguar, dua t'ua kthej shpresën dhe besimin bashkë me buzëqeshjen, në ftyrat e qytetarëve të Kosovës", ka thënë ajo. "Pra, fokusim kryesor do të jetë zhvillimi i hovshëm ekonomik bashkë me sigurinë dhe sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës", ka shtuar ajo. Kadriu ka thënë se arsyetet e shtë që ojo po synon të ofrojë një model të ri të politikanit, që, sipas saj, konkretisht i përvjet mëngët dhe jep maksimumin e aftësive që i ka, që përdor kokën e dijen e vet.

Ky artikulli i botuar më 15 maj të vitit 2014 në gazetën *Koha Ditore*, flet për aderimin e Margarita Kadriut, ish-kryeredaktore e gazetës Kosova Sot, në Partinë Demokratike të Kosovës (PDK). Titulli i artikullit është parafrazim i një citati i cili paraqitet në fund të artikullit. Vendimi redaktorial për të mbërthyer kuptimin e gjithë citatit përmes këtij titulli nuk merr parasysh pjesën tjetër të citatit ku Kadriu thotë “dua t’ua kthej shpresën dhe besimin”, para se të vazhdojë me “bashkë me buzëqeshjen në fytyrat e qytetarëve të Kosovës”. Në një vend si Kosova, ku problemet sociale dhe ekonomike janë të theksuara, vendimi redaktorial për ta paraqitur “buzëqeshjen” në vend të “shpresës dhe besimit” mund të cilësohet si tentim për të nxitur një reagim të caktuar nga ana e lexuesve, të cilët në masë të madhe i mbajnë përgjegjës figurat politike të Kosovës për kushtet e vështirë ekonomike. Por në anën tjetër, titulli mund të konsiderohet korrekt nëse shihet nga këndvështrimi i përpilimit të titujve në gazetat ditore, ku vendimi gjithmonë luhatet mes përshkrimit sa më të vërtetë të përbajtjës së artikullit, dhe arritjes së efektit të menjëhershëm të lexuesi, me qëllimin për ta nxitur atë që ta lexoje artikullin.

Në përgjithësi, teksti i artikullit është përshkrim korrekt dhe objektiv i ngjarjes në fjalë. Megjithatë, fakti që Hashim Thaçi, kryetari i partisë në të cilën aderon protagonistja, është personi i parë i cili citohet në artikull, është tregues i qartë se në këtë rast gazetari i jep përparësi përshkrimit kronologjik të ngjarjes, dhe jo domosdoshmërisht rangimit për nga rëndësia e tyre. Nga artikulli duket qartë se është Thaçi ai i cili e bën hapjen e konferencës për shtyp dhe i pari që flet, para se ta prezantojë Kadriun ai anëtaren më të re të partisë. Mirëpo në anën tjetër, mund të diskutohet rreth asaj se a është më e rëndësishme të përshkruhet ngjarja në mënyrë kronologjike, apo artikulli të fillojë me Kadriun, duke qenë se vet konferanca për shtyp është thirrur për shkak të saj. Ekziston tundimi që një raportim i tillë të cilësohet si tendencioz dhe të paraqitet si rast kur një burrë në politikë ka gjithmonë përparësi në raport me një grua politikane. Mirëpo, shikuar më për së afërm, për të qenë sa më korrekt, vlerësimi nga ana jonë duhet të marrë parasysh praktikën jo vetëm të kësaj gazetë, por të pothuajse të gjitha gazetave ditore në Kosovë, që ngjarje të tilla të protokollit të raportohen në mënyrë kronologjike, e jo sipas rëndësisë që një informatë e caktuar ka për lexuesin. Artikulli i jep hapësirë prezantimit të programit politik të protagonistës, por nuk thellohet në këtë temë përtej asaj që thuhet nga vetë protagonistja gjatë fjalimit të saj para gazetarëve. Në anën tjetër, fotografia prezanton në mënyrë korrekte protagonistët e ngjarjes, në këtë rast sipas rëndësisë së informatës – Kadriu duke folur para gazetarëve, dhe Thaçi në rol dytësor duke e dëgjuar prononcimin e saj.

Jahjaga: Gratë s'kanë trajtim të barabartë në shoqëri >

06 EPOKA ERE E MARTË, 21 PRILL 2015

AKTUALE

Presidentja Atifete Jahjaga ka marrë pjesë në konferencën "A jam e barabartë në shoqërinë kosovare?"

Jahjaga: Gratë s'kanë trajtim të barabartë në shoqëri

Presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, ka thënë se gratë dhe vajzat ende nuk kanë trajtim të barabartë në shoqëri. Sipas saj, Kosova ka hedhur hapësirë konsiderueshëm në avancimin e rolit të grusës në shoqëri, por ky progres ende mbetet i ulët

EPOKA
ERE

Lirije KLAIQI

PRISHTINË, 20 PRILL - Presidentja Atifete Jahjaga ka thënë se gratë dhe vajzat ende nuk kanë trajtim të barabartë në shoqërinë e vendit tonë. "Gratë dhe vajzat ende nuk kanë trajtim të barabartë në shoqëri. Është e vërtetë, kemi ndërtuar një infrastrukturë lëiore të avancuar, por kemi ende shumë punë për të bërë si institucione

dhe si shoqëri që t'i jetësojmë ato në praktikë dhe vetëm atëherë ne mund të themi se gratë dhe vajzat janë të barabarta në shoqërinë tonë", ka thënë Jahjaga të hënën në hapjen e konferencës "A jam e barabartë në shoqërinë kosovare". Jahjaga ka shtuar se iniciativa, si kjo e sotmja, janë më se të nevojshme për t'i nxjerrë në sipërfaqe barrierat dhe sfidat e shumta me të cilat përballen gratë si në jetën private ashtu dhe në atë publike. "I përgëzoj organizatorët e kësaj konferencë, duke shprehur bindjen se ky projekt do të arrrijë të mbledhë rreth vetes edhe më shumë përkrahës për t'i shtryrë përpara ndryshimet e nevojshme që do ta garantonin respektimin e të drejtave të barabarta të grave dhe vajzave. Kam qenë dhe mbetem i thitare e fuqishme e një krimimi të mekanizmave institucionale, ligjorë e shoqërorë, të cilët e shohin

garantimin e përmbrushjes së të drejtave të grave dhe vajzave si të pakontestueshëm. Pra, jo vetëm si një zgjedhje individuale, por si obligim e përgjegjësi qytetare dhe institucionale", ka deklaruar Jahjaga. Ajo ka shtuar se mospjesëmarrja apo pjesëmarrja e ulët e grave është në çdo fushë të jetës. "E vëmë re çdo ditë. Gratë përballen me sfida në fushë të ndryshme të jetës, të cilat krijojnë një efekt zinxhir në gatishmërinë apo jogatishmërinë e saj për t'i kërkuar të drejtat e veta", ka thënë Jahjaga. Ajo ka deklaruar se mohimi i të drejtave të grave nuk është çështje private, dhuna në familje mbi bazi gjinore nuk është çështje private, dhuna seksuale si mijet lufte e ushtruar mbi qindra mijëra gra nuk është çështje private, por është çështje që ne duhet të organizohemi si shoqëri për adresimin e duhur

të tyre. "Na takon të gjithëve ta dénojmë dhe të parandalojmë dhunën e ushtruar mbi gruan, si anëtarë të shoqërisë dhe si institucione, duke ofruar mekanizmat e duhur për t'i ndëshkuar abuzuesit dhe për t'i rehabilituar viktimat e saj, me ndihmë e medieve, duke pasqyruar e dënuar krimë të tillë. Krimet mbi baza gjinore nuk janë krimë më pak të rëndësishme, andaj duhet t'i trajtojmë ato me seriozitetin dhe me fuqinë që parareshet edhe ligji", është shprehur presidenca Jahjaga.

Ajo ka thënë se ne si shoqëri kemi hedhur hapë të kon siderueshëm në avancimin e rolit të grusës në shoqëri, por ky progres mbetet ende i ulët, veçanërisht kur kthehem i dhe shohim shifrat që vijnë nga pjesëmarrja e grusës në tregun e punës, pjesëmarrja në arsim, në politikë, qasja në shërbimet shëndetësore apo në drejtësi. "Përkundrejt tyre, ne po bëhem gjithmonë e më të ndërgjegjshëm ndaj realitetit se avancimi i rolit i grusës, si gjysma e shoqërisë, është i lidhur me avancimin e gjithmbashëm të shoqërisë që prek secilin qytetar. Po bëhem gjithmonë e më të ndërgjegjshëm që aleatëtanë në vendosjen e rendit dhe ligjit, në luftën ndaj fenomeneve negative të shoqërisë si korruptioni, duhet të jenë pikërisht gratë, të cilat kanë dëshmuar se janë shumë më pak të korruptuara, si dhe shumë më të përgjegjshme ndaj detyrave që ato marrin përsipër t'i kryejnë, faktë të mbështetur edhe nga hulumtime të ndryshme vendore dhe ndërkombe të", ka thënë Jahjaga.

Presidentja Jahjaga ka bërë me dije se do t'i drejtohet Qeverisë së Kosovës me kërkësëkrijimin e një fondi të veçantë për edukimin dhe shkolimin e vajzave dhe të grave.



Ky artikull është një tjetër shembull pozitiv i prezantimit objektiv dhe profesional të gruas në mediat e shkruara në Kosovë. I botuar më 21 prill të vitit 2015 në gazetën *Epoka e Re*, protagonistja kryesore e shkrimit është Presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga gjatë hapjes së konferencës që trajton temën e të drejtave të grave “A jam e barabartë në shoqërinë kosovare?”. Titulli i artikulli qartazi paraqet thelbin e artikullit, ku jepet një pasqyrë e gjendjes aktuale të të drejtave të grave dhe me ç'rast Jahjaga bën thirrje për avancimin e mëtejshmë të tyre. Pjesa hyrëse e artikullit mbështet titullin duke dhënë më shumë informata rreth nevojës për përmirësimin e të drejtave të grave dhe vajzave.

Në asnjë pjesë të artikullit nuk vërehet ndonjë ton afirmativ e as diskriminues ndaj figurës së Presidentes Jahjaga, e as ndaj temës së të drejtave të grave. Si i tillë, artikulli është tejet objektiv dhe i paanshëm. Megjithatë, në këtë rast, gazetarja zgjedh që pothuajse gjithë artikullin ta bazojë në citatet e drejtpërdrejta të Jahjagës. Shikuar nga ky këndvështrim, mund të konkludohet se përderisa artikulli e paraqet protagonisten e artikullit në mënyrë shumë objektive, fakti që artikulli në pjesën më të madhe bazohet në deklaratat e saj, bën që artikulli të mos japë një pasqyrë të plotë të temës të cilën e shtjellon. Kjo ndodhë për dy arsy: pikësëpari, artikulli nuk ofron kontekst në kuadër të të cilit edhe deklaratat e Jahjagës do të ishin më të fuqishme. Vendosja e temës në kontekst kohor dhe pëershkrimi i zhvillimeve të kaluara rreth temës në fjalë bën që lexuesi ta kuptojë problematikën e shtjelluar dhe rrjedhimisht të krijojë opinion të informuar dhe të shëndoshë. Për më shumë, një qasje e tillë bën që lexuesi i zakonshëm të ndjehet pjesë e diskursit publik rreth çështjes së të drejtave të grave, e jo ta shohë atë si temë me të cilën duhet të merren ekskluzivisht elitat politike e shoqërore. Së dyti, përveç Jahjagës, në artikull nuk citohet asnjë person tjetër, qoftë burrë apo grua. Me këtë rast, gazetarja humb rastin që të prezantonjë edhe gra të tjera pjesëmarrëse në këtë konference, mendimet e të cilave mund të kenë qenë po aq valide dhe relevante sa ato të Jahjagës. Por në këtë rast, më e rëndësishme mund të konsiderohet mungesa e citimit të burrave pjesëmarrës në konferencë, edhe pse nga fotografia shihet qartë se paneli i diskutuesve moderohet nga një burrë. Një qasje e tillë e forcon edhe më tej stereotipin se rreth temës së të drejtave të grave diskutojnë vetëm gratë, dhe se me këto probleme duhet të merren vetëm ato.

Shikuar në tërësi, artikulli mund të konsiderohet si shembull pozitiv i prezantimit të grave në mediat e shkruara. Gazetarja e shkrimit është objektive, e paanshme dhe nuk lëshohet në etiketime e kategorizime tendencioze. Megjithatë, artikulli humbet rastin e inicimit të një debati më të formësuar me lexuesit rreth rëndësisë së të drejtave të barabarta për vajzat dhe gratë, për shkak të mungesës së kontekstit dhe mospërfshirjes së mendimeve të pjesëmarrësve tjerë në konferencë, qofshin ata burra apo gra.

Burri e bën gruan PËR SPITAL >

KRONIKA

GAZETA BOTË SOT
E MARTË, 24 MARS 2015 11

Burri e bën gruan PËR SPITAL

Një burrë nga Lipjani, duke menduar se është burrëri të rrahësh gruan, ka përdorur dhunë fizike ndaj gruas së tij, dhe pér pasojë viktima ka përfunduar në spital. Sipas një njoftimit të policisë së Kosovës, një qytetare e Lipjanit ka pësuar lëndime trupore pasi është sulmuar fizikisht nga bashkëshorti i saj. Sipas Policisë së Kosovës, është arrestuar i dyshuar mashkull K-Shqiptar pasi që i njëjti pér arsyё tё pa njohura ka sulmuar fizikisht bashkëshorten e tij-victimën femër K-Shqiptare. Viktima ka pësuar lëndime trupore dhe e njëjta ka pranuar tretman mjekësor. Me urdhër të prokurorit i dyshuar dërgohen në mbajtje, thuhet në njoftimin e policisë.

Grushta edhe në Prishtinë

Prona u bë shkak që dy persona të grushtohen mes vete, dhe pastaj përfunduar të arrestuar. Në njoftimin e policisë së Kosovës thuhet se në rrugën

"Ilas Agushi", në Prishtinë, janë arrestuar dy të dyshuar meshkuj shqiptar, pasi që të njëjtit pas një mosmarrëveshje rreth një kontesti pronësor janë rrahuar në mes veti. Me urdhër të prokurorit të dyshuarit dërgohen në mbajtje.

Alkooli e qui në burg

Gjykata Themelore në Prizren i ka shqiptuar Shefki Halilajit- Shekit masën prej 3 vjet e dy muaj burg efektiv dhe 4.000 euro gjobë pasi që u gjet fajtor pér sulmin ndaj Stacionit të Policisë Alfa në Prizren në tetor të vitit të kaluar. Gjykimi i Shekit kishte filluar në shkurt të këtij u viti kur prokuroria kishte provuar ta arrijë një marrëveshje pér pranim të fajësisë me të dyshuarin, por e cila nuk ishte pranuar nga gjykata.

Mjete të pashpërthyera

Në Fshatin Zhur në Prizren të dielën rreth orës 13:00, ka pranuar një thirrje nga një qytetar mashkull shqiptar, i cili

ka raportuar se ka gjetur disa mjete te pa shpërthyera ne një fushë. Kreh orës 15:00 njësiti i EOD-së nga FSK kanë têrhequr pesë predha (Bomba kasetë) pa i eksploduar dhe një kokë të raketës e cila ishte e eksploduar që dyshohet të jenë mbetur nga lufta e fundit në Kosovë. Njësiti i EOD-së rreth orë 16:00 është larguar nga vendi i ngjarjes duke i marr me vete municationin ,dhe sipas tyre dyshohet se në atë si përfaqe ka ende mjete të tillë të rrezikshme të pashpërthyera." Thuhet në njoftimin e Policisë.

Po ashtu Policia e Kosovës ka njoftuar se të dielen në fshatin Kostrec në Skenderaj rreth orës 13:50, ka pranuar një ankesë nga një mashkull shqiptar ka raportuar se në oborrin e shtëpisë së tij ka gjetur një mjet të dyshuar. Njësia pér deminim e FSK-së ka dalë në vendin e ngjarjes dhe i ka têrhequr dy mjete të dyshimta (predha) me gjatësi rreth 30cm në mënyrë të sigurt" thuhet në njoftim.

zvllu 24

Artikulli i mësipërm i botuar më 24 mars të vitit 2015 në gazetën *Bota Sot*, është shembull tipik i raportimit joprofesional rreth temës së dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, në përgjithësi. Pikësëpari, titulli i artikullit "Burri e bën gruan pér spital" është tendencioz dhe kontribuon në forcimin e qëndrimeve paragjykuese shoqërore, ku rrahja e gruas nga burri në rastin më të mirë konsiderohet diçka e zakonshme, kurse në rastin më të keq, diçka që tregon "burrerinë" e ushtruesve të dhunës. Duke dashur ta justifikojë përdorimin e këtij titulli, artikulli fillon me këtë fjali: "Një burrë nga Lipjani, duke menduar se është burrëri ta rrahësh gruan, ka përdorur dhunë fizike ndaj gruas së tij, dhe pér pasojë viktima ka përfunduar në spital". Është e vështirë që në këtë përshkrim të ngjarjes të mos vërehet një tendencë sado e vogël pér ta arsyetuar veprimin e ushtruesit të dhunës, duke e cilësuar atë si një gabim apo veprim të paqëllimshëm, e jo si akt i dënueshëm i cili meriton trajtim psiko-social dhe dënim në bazë të kodit penal. Ndërkaq, është e qartë se teksti që pason këtë fjali është marrë nga raportet ditore të policisë dhe nuk përmban kurrfarë raportimi nga ana e gazetarit. Mirëpo, fakti më brengosës është se e gjithë ngjarja tregohet si pjesë e kronikës së zezë, ku ky rast i dhunës në familje është vetëm një nga ngjarjet e raportuara. Siç mund të shihet edhe nga artikulli i skanuar më lartë, tri storiet tjera nuk kanë të bëjnë fare me dhunën në familje apo dhunës ne baza gjinore, por me raste të ndryshme të krimeve kryesisht të vogla. Përkundër kësaj, redaksia e kësaj gazete ka vendosur që të gjitha temat të paraqiten përmes titullit dhe fotografisë e cila flet pér dhunën në familje dhe e cila i prezanton gratë si viktima të kësaj dhune. Sikur artikulli në fjalë të thellohej në shpjegimin e kësaj teme, edhe pse tendencioz, titulli do të mund të justifikohej si mjet i përdorur pér të térhequr vëmendjen e lexuesit. Por, në këtë rast, është e qartë se artikulli nuk ofron asnje vlerë të shtuar përmes shtjellimit të kësaj teme nga perspektiva gjinore, por mjaftohet me ofrimin deskriptiv të informacionit, duke e bërë kështu të qartë qëllimin prapa vendimit pér ta përdorur titullin në fjalë.

Vetëm 16 për qind e femrave kanë prona >

KOSOVA SOT | 9
E MARTË, 15 DHJETOR 2015

TË DREJTAT PRONËSORE NË KOSOVË



Vetëm 16 për qind e femrave kanë prona

Prona e paluajtshme duhet të regjistrohet edhe në emër të grave

Me qëllim të inkurajimit të femrave për të gjëzuar këtë të drejtë, çështjen e regjistrimit të pronës në emër të gjinisë femërore e ka vënë prioritet Agjencja Kadastrale e Kosovës

Pjesëtaret e gjinisë femërore Kosovë jo shpesh i gjëzojnë të drejtat pronësore, pasi shumica e pronave janë të regjistrara në emër të meshkujve. Edhe pse gjysma e popullatës së përgjithshme në Kosovë përfaqësohet nga gjinia femërore, sipas statistikave zyrtare, vetëm mbi 16 për qind e pronave të paluajtshme janë të regjistrara në emër të femrave. Murat Meha, kryeshef ekzekutiv në Agjencjinë Kadastrale të Kosovës, ka thënë se më qëllim të inkurajimit të femrave për të gjëzuar këtë të drejtë, çështjen e regjistrimit të pronës në emër të gjinisë femërore e kanë vënë prioritet në këtë agjenci. "Tani pronën e regjistruar në emër të gjinisë femërore e kemi mbi 16 për qind. Atë e përcjellim çdo ditë, i inkurajojmë edhe përmes projekteve për regjistrimin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme, siç janë projektet që jemi duke zhvilluar të Bankës Botërore, në 50 zona kadastrale, në 10 komuna".

Shoqëria civile hulumton situatën
 Por, përfaqësues të shoqërisë civile konsiderojnë se në shumicën e rasteve prona e paluajtshme regjistrohet në emër të gjinisë femërore për interesat e ngushtave.

Në shumë raste, sipas përfaqësuesve të shoqërisë civile, tradita sfidon ligjet

E drejta në pronë është e drejtë themelore që garantonohet nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligjeve ekzistuese në fuqi

familjare. Problemet e shumta në këtë rast, kanë detyruar organizatën joqeveritare "Aureola" që të zhvillojë një hulumtim për këtë çështje, publikimi i të cilit pritet shumë shpejtë. Drejtoresha ekzekutive në këtë organizatë, Sanije Grajcevi, ka thënë se gjimia mashkullore duhet të vetëdijoshet se regjistrimi e pronës në emër të nënës, gruas apo motrës nuk falet, por është diçka që u takon në bazë llojore. "Ka gra të cilat e gjëzojnë pronën, por për ne kjo nuk është e kënaqshme, pasi kryesisht kemi hasur në raste që, për të marrë ndonjë kredi apo për t'u liruar pre tatimeve, pronat regjistrohen në emër të tyre dho jo pse u takon", tha Grajceveci.

Regjistrimi sipas mentalitetit
 Arianit Morina, student në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës, pohon se regjistrimi i pronave të paluajtshme, varet edhe nga mentaliteti i familjeve në të cilin jeton gruaja. "Prona e paluajtshme duhet të regjistrohet edhe në emër të grave. Por, sidoqoftë kjo varet edhe nga traditat që kanë familjet ku jetojnë gratë", thotë Arianiti. Pavarsisht asaj se a regjistrohen pronat e paluajtshme në emër të dy bashkëshortëve, me rastin e marrjes së ndonjë kredie në bankat komerciale dhe lënes në hipotekë të pronës se paluajtshme, të dy bashkëshortët janë të obliguar të nënshkruan për atë pronë. Ky veprim i bankave, sipas Murat Mehës, duhet të shfrytëzohet si vetëdijesim i femrave se prona duhet të jetë e regjistruar në emër të përbashkët të të dy bashkëshortëve dhe jo vetëm për raste të caktuara.

/rel/

Artikulli i mësipërm i botuar më 15 dhjetor të vitit 2015 në gazetën *Kosova Sot* flet për nivelin e ulët të regjistrimit të pronave të paluajtshme në emër të grave. Ky shkrim është një shembull i mirë i raportimit të drejtë, të balancuar, dhe profesional. Përmes titullit, artikulli vë në pah elementin më brengosës që ndërlidhet me këtë temë, faktin se vetëm 16 për qind e grave në Kosovë kanë prona. Vetë teksti i artikullit është i balancuar dhe përfshinë mendimet e përfaqësuesve të institucioneve, shoqërisë civile, si dhe të qytetarë të zakonshëm. Strukturalisht, artikulli është i ndarë në tri pjesë, në të cilat akomodohen pikëpamjet e përfaqësuesve të këtyre kategorive.

Së pari, në artikull citohet Murat Meha, kryeshefi ekzekutiv në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, i cili shpjegon se institucioni që drejtohet nga ai ka prioritet çështjen e regjistrimit të pronës në emër të grave. Në artikull, Meha përmend edhe projekte specifike përmes të cilëve synohet të arrihet një gjë e tillë.

Pjesën e dyte të artikullit e zënë përfaqësuesit e shoqërisë civile, përmes deklaratave të të cilëve, artikulli ia arrin që saktë dhe thuktë t'i artikulojë problemet kryesore që ndërlidhen me çështjen e pronave në emër të grave. Në artikull përfshihet edhe një grua, Sanije Grajçevci, drejtoreshë ekzekutive në një organizatë joqeveritare, e cila sipas autorit të artikullit, në kohën kur është botuar artikulli ka qenë duke punuar në një hulumtim në lidhje me këtë çështje. Autori i artikullit citon Grajçevcin duke shpjeguar se si, përkundër ndryshimeve pozitive, regjistrimi i pronave në emër të grave shpeshherë bëhet me qëllim të marrjes së kredive apo me qëllim të lirimit nga tatimet, e jo si rezultat i respektimit të së drejtës së grave për pronësi.

Në pjesën e tretë, artikulli përfshin mendimet e një studenti të Fakultetit Juridik, i cili thotë se çështja e regjistrimit të pronës në emër të grave varet edhe nga mentaliteti i familjes në të cilën jeton gruaja. Në fund, artikulli thekson se pavarësisht asaj se a regjistrohen pronat e paluajtshme në emër të dy bashkëshortëve, me rastin e marrjes së ndonjë kredie në bankat komerciale dhe lénies në hipotekë të pronës së paluajtshme, të dy bashkëshortët janë të obliguar të nënshkruajnë për atë pronë. Edhe pse një gjë e tillë bëhet nga bankat me qëllim të uljes së rrezikut për moskthimin e borxhit, në artikull parafrazohet edhe njëherë Meha, i cili thekson se një gjë e tillë mund të shfrytëzohet për vetëdijesimin e vajzave dhe grave për rëndësinë e regjistrimit të pronave në emër të përbashkët të bashkëshortëve.

Si përfundim, mund të thuhet se artikulli jep një pasqyrë reale të problemit të cilin e shtjellon. Edhe pse i shkurtër, ai arrin t'u japë hapësirë të gjitha pikëpamjeve që ndërlidhen me këtë problematikë, duke filluar nga përfaqësuesi i institucionit që merret me regjistrimin e pronave, përfaqësuesja e një organizate joqeveritare, dhe studenti i Fakultetit Juridik. Për më shumë, në fund, artikulli tregon edhe për hapësirat të cilat mund të shfrytëzohen me qëllim të adresimit të nivelit të ulët të regjistrimit të pronës në emër të grave. Lëshimi i vetëm i artikullit është fakti se nuk bëhet dallimi mes termit "femër" si nocion biologjik, dhe termit "grua" si nocion shoqëroro-kulturor. Për fat të keq, ky keqkuptim i nocioneve mund të haset edhe në Ligjin për Barazi Gjinore, por edhe në diskursin më të gjerë publik në Kosovë.

Duhet theksuar se artikulli është prodhim i Radios Evropa e Lirë dhe jo i gazetës *Kosova Sot*. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet dhe vlerësohet fakti që redaksia e gazetës ka vendosur ta publikojë atë, dhe së këndejmi, të ndikojë në informimin e drejtë të qytetarëve në lidhje me këtë çështje.

6. Grupi i fokusit me gazetarë

6.1 Metodologja

Kriteri kryesor për përzgjedhjen e pjesëmarrësve në këtë grup të fokusit ka qenë ushtrimi aktiv i profesionit të gazetarit në mediat e shkruara.³³ Gjithashtu, kriteri shtesë për pjesëmarrje në këtë grup të fokusit ka qenë edhe trajtimi i temave që kanë të bëjnë me gratë nga ana e gazetarëve. Në këtë grup të fokusit kanë marrë pjesë edhe dy gazetare të portaleve dhe një gazetare e televizionit të vetëm publik në Kosovë, me qëllim që rezultati i diskutimit të jetë sa më gjithëpërfshirës. Shumica e gazetarëve që kanë marrë pjesë në diskutim nuk janë të specializuar në një fushë të caktuar. Vetëm dy nga nëntë pjesëmarrësit kanë deklaruar se mbulojnë një fushë të caktuar, përkatësisht zhvillimet politike. Të gjithë pjesëmarrësit tjerë kanë theksuar se mbulojnë nga dy deri tri fusha të ndryshme gjatë punës së tyre, përfshirë politikën, arsimin, ekonominë, shëndetësinë, prokurimin publik, korrupsionin etj. Vetëm njëri nga pjesëmarrësit ka qenë korrespondent nga terreni, dhe i njëjtë ka theksuar se korrespondentët nuk janë të specializuar, por i mbulojnë të gjitha fushat varësisht nga zhvillimet në vendbanimet prej nga raportojnë.

6.2 Gjetjet kryesore nga grupi i fokusit

Shumica e pjesëmarrësve ne fokus grup kanë thënë se gjatë punës së tyre dhe gjatë trajtimit të temave në baza ditore nuk bëjnë as diskriminim pozitiv e as negativ në baza gjinore. Sipas tyre, gjatë përgatitjes së storieve dhe kontaktimit të personave që përfshihen në to, gratë nuk favorizohen vetëm për shkak të përkatësisë gjinore, dhe në pothuajse të gjitha rastet, kriteri profesional është ai që përdoret për ta bërë përzgjedhjen e personave që thirren për të qenë pjesë e një artikulli të caktuar.

Sa i përket roli që gazetaret luajnë në peisazhin mediatik të Kosovës, me theks të veçantë në televizione, shumë nga pjesëmarrësit kanë thënë se ato mungojnë në disa pozita kyçe. Sipas njërs nga pjesëmarrëset në diskutim, gratë shpesh konsiderohen më shumë si objekt, sesa subjekt. Sipas saj, në pothuajse të gjitha emisionet më serioze, e sidomos në debatet politike, mysfirët janë kryesisht burra. Për më shumë, janë tepër të pakta rastet kur ndonjë emision i llojit të tillë moderohet nga gratë. Në rolin e moderatores, gratë mund të hasen kryesisht në emisione “ku vlerësohet më shumë pamja se sa thelbi”, apo ne emisione ku flitet për familje dhe tema argëtuese. Megjithatë, po e njëjta diskutuese ka thënë se kjo ndodhë për shkak të një lloj vetë diskriminimi, si dhe mungesës së ambicies dhe këmbëngulësisë nga ana e grave që të janë pjesë e këtyre emisioneve. “Unë mendoj se askush nuk na diskriminon, nëse jemi të gatshme me diskutu dhe me debatu. Askush nuk mendoj se i ka thënë ndokujt ‘mos eja [në emision] se je femër, apo eja se je femër’, ka thënë kjo folëse. Por, njëra nga pjesëmarrëset

³³ Pjesëmarrës në fokus grup kanë qenë gazetarë të këtyre mediave: Epoka e re, Koha Ditore, Kolona.info, Kosova Info, Periskopi, RTK, dhe Zëri.

ka theksuar se në Kosovë, në përgjithësi, ka shumë gazetare, dhe se në televizionin e vetëm publik, ka shumë gra në pozitën e redaktorit të lajmeve. “Në një pikë shumica kemi qenë femra”, ka thënë kjo pjesëmarrëse. Megjithatë, e njëjtë pjesëmarrëse ka theksuar se fuqinë vendimmarre me gjithatë e kanë burrat, pasi që në pozitat më të larta, si ato të redaktorit përgjegjës apo kryeredaktorit, janë kryesisht burra, me përjashtim të një redaktoreje përgjegjëse për emisionet e minoritetave, dhe një ish-zëvendësdrejtoreshe gjenerale.

Në lidhje me paraqitjen e grave ne mediat e shkruara, disa nga pjesëmarrësit kanë theksuar se gratë shpeshherë sulmohen në media. Kjo folëse ka përmendur skenën politike, ku një grua sulmohet për diçka shumë të vogël, kurse burrat vetëm atëherë kur janë të përfshirë në ndonjë skandal të përmasave shumë të mëdha. Si shembull ilustrimi është përmendur rasti kur, me rastin e hedhjes së gazit në parlament si pjesë e bllokadës së punës së parlamentit nga deputetët e opozitës, mediat janë marrë me ditë të tëra rrëth asaj se si i kanë futur gratë deputete bombolat e gazit në sallën e kuvendorit. Sipas kësaj folëse, askush nuk e ka diskutuar se si e kanë futur deputetët burra gazin në atë sallë. Një qasje e tillë, sipas pjesëmarrësve, ka treguar një diskriminim të theksuar në baza gjinore. Por njëri nga pjesëmarrësit ka thënë se edhe kryeministri Mustafa shpeshherë është komentuar dhe shpotitur për paraqitjet e tij gjatë negociatave në Bruksel. Sipas tij, edhe pse ish-presidentja Jahjaga ka qenë më së shumti në fokus të mediave, ka shumë të tjerë, si gra ashtu edhe burra, veprimet e të cilëve janë komentuar në mënyrë tallëse.

Një tjetër problem që është përmendur gjatë diskutimeve ka qenë ai i mungesës së grave si burime të lajmeve apo storieve. Gjatë përgatitjes së artikujve, pothuajse në të gjitha rastet, janë vetë gazetarët ata të cilët vendosin se kë do ta intervistojnë. Në të shumtën e rasteve, protagonistët e storieve janë burra. Pjesëmarrësit në diskutim kanë qenë të ndarë rrëth asaj se pse ndodhë një gjë e tillë. Sipas një grupei diskutuesish, kjo ndodhë për shkak se “nuk ka ofertë” për të ofruar opinion nga ana e grave, dhe se shpeshherë ato nuk janë sa duhet bashkëpunuese. Sipas këtij grupei, ka raste të shumta kur gratë të cilat janë në parti politike, e ndoshta edhe në pozita të larta udhëheqëse në strukturat partiake, refuzojnë të përgjigjen në thirrjet e gazetarëve për të komentuar në lidhje me çështje të caktuara politike. Njëri nga pjesëmarrësit ka theksuar se ka pasur rast kur një nga to kishte thënë se nuk mund të prononcohet pa u konsultuar me kryetarin e partisë, edhe pse vetë ka qenë në pozitë të lartë udhëheqëse në atë parti. Në anën tjetër, të njëjtë pjesëmarrës kanë thënë se, marrë në përgjithësi, burrat janë më të prirë për bashkëpunim. Edhe pse ata shpesh mund të mos jenë më të kualifikuarit për të dhënë një prononcim të caktuar, sipas pjesëmarrësve, gazetarët punojnë në ambient shumë dinamik dhe si rezultat, tentojnë të kontaktojnë ata persona që mendojnë se nuk do të ngurrojnë të bashkëpunojnë. Njëra nga gazetaret ka treguar se tenton që sa herë të jetë e mundur të përfshijë gra profesioniste në storiet e saj, por se një gjë e tillë nuk është gjithmonë e lehtë. Ajo ka shpjeguar një rast kur është munduar të marrë një prononcim nga disa nga ish profesoreshat e saj, por të gjitha prej tyre kanë hezituar, duke kërkuar që t'u dërgohen pyetjet paraprakisht, para se të vendosin se a duan të jenë pjesë e stories apo jo. Për më shumë, të gjithë pjesëmarrësit kanë konfirmuar se në asnjërin medium ku ata punojnë, nuk ekziston ndonjë mekanizëm i brendshëm apo kriter i caktuar në lidhje me përzgjedhjen e individëve për një storie të caktuar, e i cili do të rregullonte përfaqësimin e baraspeshuar gjinor.

Grupi tjetër i pjesëmarrësve kanë theksuar se ka shumë gra të cilat janë kompetente në fushën e tyre dhe profesionaliste të përgatitura, por se atyre rrallëherë u jepet mundësia për bashkëpunim. “Mediat kanë përgjegjësi t'i qesin në pah këto femra,” ka theksuar njëra nga diskutueset. Për më shumë, njëra nga gazetaret ka thënë se mediat kanë një detyrë më madhore se raportimin, e ai është edukimi i njerëzve. Sipas saj, përmes servimit të artikujve

të parëndësishëm dhe pa ndonjë vlerë, mediat ndikojnë negativisht tek lexuesit. "Mediat e mësojnë lexuesin. Mediat mund ta edukojnë lexuesin" ka thënë kjo gazetare.

Njëra nga diskutueset ka thënë se ka fusha në të cilat nuk ka eksperte gra. Megjithatë, një vlerësim i tillë nga ana e pjesëmarrëses në diskutim mund të konsiderohet më shumë si deklaratë stereotipike e bazuar në opinion personal. Përderisa nuk ekziston një bazë të dhënat e nivel vendi i cili do t'i identifikonte profesionistët sipas ekspertizës dhe gjinisë, një qëndrim i tillë mund të konsiderohet si problematik, sepse paraqet një pengesë të panevojshme në ngritjen e nivelit të përfaqësimit dhe përfshirjes së grave eksperte nëpër artikujt e gazetave të shkruara, si pasojë e një besimi tërësisht subjektiv dhe faktikisht të gabueshëm. E njëjtë diskutuese ka theksuar se siguria është një fushë e tillë ku pothuajse të gjithë ekspertët janë burra. Megjithatë, vlen të theksohet se për ndryshim nga rasti kur vlerësohet se ka fusha në të cilat nuk ka eksperte gra, në rastin e fushës së sigurisë, fakti që ekspertët janë burra nuk ka ndonjë ndikim të veçantë, pasi që pavarësisht gjinisë, ekspertët e sigurisë i njobin efektet që çështjet e sigurisë i kanë si tek burrat, ashtu edhe tek gratë, fëmijët dhe pleqtë. E njëjtë folëse ka theksuar se ka shumë e shumë raste kur për një fushë të caktuar nuk ka fare eksperti, as gra e as burra. Sipas saj, shumica e ekspertëve dhe analistëve në Kosovë janë të përgjithshëm, e jo të specializuar në një disiplinë të caktuar.

Sa i përket promovimit të grave në mediat e shkruara, shumica e pjesëmarrësve kanë qenë të mendimit se kjo gjë nuk varet vetëm nga gazetarët. Edhe pse të gatshëm ta bëjnë një gjë të tillë, ata kanë theksuar se duhet të kenë arsyë për ta promovuar një person të caktuar. Si shembull, folësit kanë përmendur sportin si fushë në të cilën kohët e fundit sportistet kanë shënuar suksese të njëpasnjëshme dhe rrjedhimisht janë promovuar vazhdimisht. Njëra nga gazetaret ka thënë se "Majlinda [Kelmendi] mbulohet sepse ajo është e suksesshme, por nuk mbulojmë shumë njerëz [tjerë] që nuk janë të njobur për publikun". Disa pjesëmarrës kanë thënë se është detyrë e mediave që t'i promovojnë edhe ato gra të cilat janë të suksesshme, por për të cilat publiku i gjërë ende nuk ka pasur mundësi të njoftohet. Njëra nga gazetaret ka përmendur rastin kur ka insistuar ta promovojë një grua të suksesshme në radhët e policisë, vetëm për shkak se ka konsideruar se ky institucion gati gjithmonë identifikohet me gjininë mashkulllore. Megjithatë, e njëjtë folëse ka shpjeguar se ky artikull ka qenë pjesë e edicionit të vitit të ri kur botohen storie me një qasje "pak më ndryshe se gjatë vitit". Kjo bën të kuptojmë se një promovim i tillë është më shumë përjashtim sesa rregull, dhe se promovimi i grave nuk është pjesë e praktikës profesionale ne raportimet e përditshme.

Njëra nga folëset ka thënë se është e gatshme t'i promovojë edhe gratë politikane "nëse kishin pasë suksese". "Detyra jonë e shenjtë është me e promovu atë që e meriton, e jo atë që nuk e meriton", ka shtuar kjo folëse. Mirëpo, ajo nuk ka elaboruar më tej se në bazë të çfarë kritereve determinohet nëse një politikane është e suksesshme apo e pasuksesshme. Për më shumë, nga ky qëndrim mund të kuptojmë se gazetarët, me ose pa vetëdije, marrin vendime të rëndësishme në baza ditore në lidhje me promovimin apo mos promovimin e një personi të caktuar. Duke qenë se personat promovohen nga mediat, kurse mediat nuk promovojnë personat e panjohur, mund të konkludohet se janë kryesisht individët dhe personat veçse të njobur për publikun, qoftë politikanë apo ekspertë të fushës, si gra ashtu edhe burra, ata të cilët vazhdojnë ta dominojnë krijimin e diskursit publik në Kosovë. Një rrëth i tillë vicioz nuk lë hapësirë të mjaftueshme për promovimin jo vetëm të grave të suksesshme, por as edhe të mendimeve dhe ideve të ndryshme në përgjithësi. Për më shumë, gjatë diskutimit është vërejtur nevoja e theksuar për ofrimin e trajnimeve specifike, përmes të cilave gazetarët do të pajiseshin me njoburitë e nevojshme për të hartuar shkrime objektive, profesionale dhe të balancuara në aspektin e perspektivës gjinore.

Përfundimet dhe rekomandimet

Rekomandimet e mëposhtme janë bazuar në analizën e mësipërme të materialit të mbledhur për prezantimin e grave në mediat e shkruara për vitet 2014-2015, si dhe në bazë të gjetjeve nga grupi i fokusit dhe identifikimit të nevojës së përgjithshme për përmirësimë të mëtutjeshme në këtë fushë.

- Organet vendimmarrëse të mediave të shkruara duhet të krijojnë mekanizma që mundësojnë raportim të balancuar në aspektin gjinor në të gjitha fushat. Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet nevojës që gazetarët të trajnohen dhe pajisen me njohuri adekuate mbi Treguesit e Ndjeshëm Gjinorë për Media (GSIM) të UNESCO-s.
- Bordet redaktoriale të mediave të shkruara duhet të krijojnë kushte për ofrimin e trajnimeve adekuate dhe të specializuara për gazetarët e tyre, me qëllim të raportimit profesional e cilësor në të gjitha fushat, e sidomos në ato ku vajzat dhe gratë janë protagonistet kryesore, siç janë shkrimet që kanë të bëjnë me dhunën ndaj grave, dhunën në familje, dhe gratë në politikë. Në këtë rrafsh, një vëmendje e shtuar duhet t'i kushtohet përmirësimi të qasjes së gazetarëve në raport me shkrimet që ngërthejnë në vete nacione komplekse, siç janë morali, seksualiteti dhe normat e etabluara shoqërore e kulturore.
- Qeveria e Kosovës, së bashku me bordet redaktoriale të mediave të shkruara dhe shoqërinë civile, duhet të punojë në edukimin e qytetarëve, e sidomos të të rinjve rreth perceptimit sa më real të shkrimeve dhe imazheve që u servohen në media, me qëllim të zvogëlimit të ndikimit që ato kanë në forcimin e stereotipeve ekzistuese.
- Mediat e shkruara duhet të ofrojnë hapësirë të mjaftueshme për promovimin e vajzave dhe grave të suksesshme, sidomos në fushat të cilat konsiderohen apriori burrërore.
- Mediat e shkruara duhet të jenë më të kujdeshshme që raportimet e gazetarëve, sidomos ato që kanë të bëjnë me dhunën ndaj grave, t'u nënshtronhen kritereve strikte të raportimit objektiv dhe të ndjeshëm. Mbetet shqetësues fakti që dhuna ndaj grave shpeshherë raportohet si pjesë e kronikës se zezë apo ngjarjeve protokollare, me ç'rast vërehet mungesa e qasjes analitike dhe vetëdijesimit të lexuesve me qëllim të parandalimit të këtij fenomeni negativ.
- Mediat e shkruara duhet ta përmirësojnë qasjen e tyre ndaj promovimit të barazisë gjinore, jo vetëm përmes ofrimit të hapësirës së mjaftueshme, por edhe përmes ngritjes së cilësisë së shkrimeve të cilat do te ndikonin në vetëdijesimin e qytetarëve për efektin negativ të këtyre fenomeneve në shoqëri, dhe në inkurajimin e vendimmarrësve për inicimin dhe implementimin e politikave dhe praktikave adekuate që garantojnë barazi gjinore.

- Institucionet e medias duhet të sigurojnë që bordet e tyre menaxheriale dhe redaktoriale të kenë përfaqësim të balancuar gjinor.
- Institucionet akademike të përgatitjes së gazetarëve të ardhshëm, dhe më gjërë, duhet të konsiderojnë krijimin dhe përfshirjen e moduleve mbi barazinë gjinore në programin akademik shkollor.
- Shmangia nga gjuha që patronizon ose shpërfill gjininë grua dhe nga gjuha që forcon stereotipet dhe imazhet e pabarazisë gjinore, si për burrat ashtu edhe për gratë.
- Mediat duhet të sjellin zërin e ekspertit në formë të balancuar, duke prezantuar si ekspertë burra, ashtu dhe eksperte gra. Krijimi i bazës së të dhënave apo listës së ekspertëve në baza gjinore nga institucionet mediatike do të ishte faktor ndihmues në këtë drejtim dhe do të krijonte një balancim gjinor, por njëkohësisht do të zgjeronte edhe përfaqësimin e shtresave dhe grupeve të ndryshme shoqërore dhe etnike, duke siguruar një përfaqësim gjithëpërfshirës të shoqërisë në faqet e mediave të shkruara.
- Mandatimi i rregullatorit për media për përcjellje, analiza dhe raportime të rregullta mbi ndjeshmërinë gjinore të mediave, si dhe për vendosjen e sanksioneve të mirë specifikuara.

Referencat

Jeffrey Gottfried dhe Elisa Shearer. "News Use Across Social Media Platforms 2016," *Pew Research Center*, 26 maj, 2016. [http://www.journalism.org/2016/05/26/news-use-across-social-media-platforms-2016/0/](http://www.journalism.org/2016/05/26/news-use-across-social-media-platforms-2016/)

Fazliu A. (2013). Depërtimi dhe përdorimi i internetit në Kosovë. Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit të Kosovës (STIKK).
http://stikk.org/fileadmin/user_upload/Depertimi_dhe_perdorimi_i_internetit_ne_Kosove_01.pdf

OSBE (2010). *Tirazhi dhe politizimi i mediave të shkruara në Kosovë*.
<http://www.osce.org/sq/kosovo/67791?download=true>

Kushtetuta e Republikës së Kosovës (2008).
<http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republike.se.Kosoves.pdf>

Agjencia për Barazi Gjinore (2012). *Prezantimi i grave në mediat e shkruara 2010-2011*.
<http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/ABGJ-Hulumtimi%20Grat%C3%AB%20n%C3%AB%20Mediat%20e%20Shkruara%20%202011-2012.pdf>

Ligji për Barazinë Gjinore (2015). <https://mapl.rks-gov.net/getattachment/165dc3a6-5295-4d24-8437-a50f8ed4e237/LIGJI-NR--05-L-020-PER-BARAZI-GJINORE.aspx>

Council of Europe (2014). *Gender Equality Strategy 2014-2017*.
<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=0900001680590174>

O'Connell H. *The European Union's new Gender Action Plan 2016-2020: Gender equality and women's empowerment in external relations*. <https://www.odi.org/sites/odi.org.uk/files/odi-assets/publications-opinion-files/9926.pdf>

Agjencia për Barazi Gjinore (2008), *Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2008-2013*.
[http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/ABGJ%20Programi%20i%20Kosoves%20per%20Barazi%20Gjinore%20\(2\).pdf](http://abgj.rks-gov.net/Portals/0/ABGJ%20Programi%20i%20Kosoves%20per%20Barazi%20Gjinore%20(2).pdf)

UNESCO (2012). *Gender-Sensitive Indicators for Media: Framework of indicators to gauge gender sensitivity in media operations and content*.
<http://unesdoc.unesco.org/images/0021/002178/217831e.pdf>

The Global Media Monitoring Project (2015). *Gender inequality in the news 1995-2015*.
http://cdn.agilitycms.com/who-makes-the-news/Imported/reports_2015/highlights/highlights_en.pdf

Beijing Declaration and Platform for Action (1995).
<http://www.un.org/womenwatch/daw/beijing/pdf/BDPfA%20E.pdf>

European Women's Lobby. *From Words to Action – Beijing+20 Report*.
<http://www.womenlobby.org/From-Words-to-Action-Beijing-20-Report>

Council of the European Union (2015). *Council Conclusions on the Gender Action Plan 2016-2020*
<http://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2015/10/26-fac-conclusions-gender-development/>

Council of Europe (2014). *Gender Equality Strategy 2014-2017*.
<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=0900001680590174>

IREX Media Sustainability Index 2016. *The Development of Sustainable Independent Media in Europe and Eurasia*, fq. 70.
<https://www.irex.org/sites/default/files/pdf/media-sustainability-index-europe-eurasia-2016-full.pdf.pdf>

Anthonissen, C. (2001). *On the effectivity of media censorship: An analysis of linguistic, paralinguistic and other communicative devices used to defy media restrictions*, Disertacioni i doktoraturës, Universiteti i Vjenës, fq.300.

Van Dijk, Teun A. (1998). *Discourse and power*, fq. 85. [Verzion i Google Books].
<https://books.google.com/books?id=OwwdBQAAQBAJ&printsec=frontcover&dq=inauthor%22Teun+A+Van+Dijk%22&hl=en&sa=X&ved=0ahUKEwjJpNu80MDSAhXIBSwKHTYIDV8Q6AEIKjAD#v=snippet&q=dissident&f=false>

Kress G. R. dhe van Leeuwen T. (1996). *Reading images: The grammar of visual design*. [Verzion i Google Books].
https://books.google.com/books?id=vh07i06q-9AC&printsec=frontcover&source=gb_ge_summary_r&cad=0#v=onepage&q&f=false

Schudson, M. (2001:150). *The objectivity norm in American journalism*.

